



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 3 MAJ 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON  
KRYETARI I KUVENDIT  
GRAMOZ RUÇI**

*(Seanca filloi në orën 10:00)*

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 19.04.2018 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Raporti i veprimtarisë vjetore të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017 *(neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet titullari i institucionit *(jo më shumë se 60 minuta)*.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Pyetje

Diskutime *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, nga një kryetar grupi ose nga 10 deputetë)*

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

4. Raporti vjetor i veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për vitin 2017 *(neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet titullari i institucionit *(jo më shumë se 60 minuta)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pyetje

Diskutime *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, nga një kryetar grupi ose nga 10 deputetë)*

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

5. Projektligji “Për strehimin social” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime.

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit (në parim, nen për nen, në tërësi)

6. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës *(neni 45 i Rregullores)*

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

**Gramoz Ruçi** – Të futen mediet brenda!

Seancën plenare të ditës së sotme e deklaroj të hapur!

*(Pasi lexon rendin e ditës.)*

Ju njoftoj se vijon puna në komisionet parlamentare për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara për seancën plenare të ditës së sotme.

Siç ju thashë, në rendin e ditës janë dy raportime, por zoti Tufa dje ka konfirmuar pjesëmarrjen, ndërsa sot është lidhur me shërbimet e Kuvendit dhe u ka thënë se nuk është në Shqipëri dhe se ka deleguar zëvendësin e tij.

Sipas Rregullores së Kuvendit, nuk mund të delegohet raportimi në Kuvend, kështu që kjo çështje do të shtyhet për në seancën e ardhshme.

Ka ndonjë vërejtje për procesverbalin e seancës plenare të datës 19.04.2018? Nuk ka. Miratohet.

Ju njoftoj se në Kuvend janë propozuar dy projektligje nga Këshilli i Ministrave, si dhe është propozuar kandidatura e zonjës Ketrin Topçiu, si anëtare e Këshillit Drejtues të AKEP-it.

Nga institucionet e krijuara me ligj, ka depozituar raportin Autoriteti i Mbikëqyrjes

Financiare. Si gjithmonë, materialet do t'i gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit në internet. Titujt e tyre i keni të gjithë përpara te njoftimet e seancave.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, me raportin e veprimtarisë vjetore të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017.

Ftoj zonjën Juliana Latifi për të marrë fjalën!

Mund të vazhdoni, zonja Latifi!

**Juliana Latifi** – Mirëmëngjesi!

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Jam këtu para jush për të prezantuar veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017.

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2017 synoi që misioni i tij për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg të ishte në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit dhe në të mirë të të gjithë konsumatorëve. Ne besojmë se konkurrenca e lirë përbën një nga shtyllat e rëndësishme në ekonomi, që rrit eficiencën e tregjeve dhe për rrjedhim ndikon në rritjen e mirëqenies në terma afatgjatë.

Viti 2017 është konsideruar, si viti i konsolidimit të ekuilibrave ekonomikë dhe financiarë të vendit. Ekonomia shqiptare në vitin 2017 u pozicionua e 75-ta në renditjen e indeksit global të konkurueshmërisë, nga pozicioni i 80-të, ku ishte klasifikuar për vitin 2016, duke lënë pas vendet e rajonit, si Serbia, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina, referuar raportit më të fundit të konkurueshmërisë së Forumit Ekonomik Global.

Gjatë veprimtarisë së tij për vitin 2017, nëpërmjet monitorimeve, vlerësimit të ankesave, hetimeve dhe vendimmarrjes Autoriteti i Konkurrencës ka ndërhyrë në mënyrë të vazhdueshme në tregje me problematika të përsëritura, si: tregu i karburanteve, tregu i telefonisë celulare, tregu financiar dhe ai i sigurimeve, tregu i transportit detar të udhëtarëve dhe mallrave dhe tregu i energjisë.

Nëpërmjet procedurave të monitorimeve dhe hetimeve, Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2017 ka vlerësuar këto elemente konkurruese: struktura e tregut dhe dinamika e zhvillimit të tij, sjellja e ndërmarrjeve në treg në lidhje me konkurrentët e tjerë, mbrojtja e

interesave të konsumatorëve, si dhe barrierat ligjore dhe ekonomike për hyrësit e rinj në treg.

Gjatë vitit 2017, monitorimet, hetimet dhe vendimmarrja e Komisionit të Konkurrencës, u shtrinë përkatësisht në këto tregje:

- Tregu me pakicë i shërbimeve celulare;
- Tregu bankar;
- Tregu i shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura me të për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit;
- Tregu i shfaqjes së filmave në kinematë e qytetit të Tiranës;
- Tregu i produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumërave për bukën dhe nënproduktet e saj;
- Tregu i transportit ajror të udhëtarëve ndaj ndërmarrjes “Austrian Airlines”;
- Tregu i shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve;
- Tregu i furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit;
- Tregu i transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës;
- Tregu i shërbimit funeral në Bashkinë Berat;
- Tregu i importit, depozitimit, shitjes me shumicë, shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të produktit gaz i lëngshëm për konsumim familjar dhe për biznesin;
- Tregu i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit;
- Tregu i gazit natyror (në bashkëpunim me ERE-n);
- Tregu i shërbimit të furnizimit me ujë dhe i largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (në bashkëpunim me ERRU-në);
- 47 vendime të marra nga Komisioni i Konkurrencës, nga të cilat 16 vendime janë për dhënie e autorizimeve për përqendrim.

Gjatë vitit 2017, Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të Rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016”, ka vazhduar veprimtarinë e tij në drejtim të rritjes së rolit të Autoritetit të Konkurrencës në monitorimin dhe hetimin e këtyre tregjeve, kryesisht:

1. Në tregun e karburanteve, gazit dhe furnizimit me karburant të avionëve (2 vendime gjatë vitit 2017);

2. Në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (një vendim);

3. Në tregun farmaceutik (ka vazhduar monitorimin);

4. Në tregun e prokurimeve publike (ka vazhduar monitorimin);

5. Në sektorin bankar (mbylli hetimin dhe u shpreh nëpërmjet një vendimi).

Gjatë vitit 2017, Autoriteti i Konkurrencës ka vazhduar të luajë rolin e tij si lider i kapitullit të 8-të, “Politikat e konkurrencës në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”, si dhe ka përmbytur detyrimet që burojnë nga ajo marrëveshje, veçanërisht në miratimin e një kuadri ligjor sekondar me *acquis* të BE-së.

Konkretisht, gjatë vitit 2017 janë miratuar dy akte:

- Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve të transferimit të teknologjisë”, e cila është përshtatur dhe përafuar plotësisht me Rregulloren e Komisionit Europian “Për zbatimin e nenit 101, paragrafi i tretë i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Europian.”

- Broshura informuese “Programi i përputhshmërisë me rregullat e konkurrencës”, dokument, i cili bazohet në të njëjtin dokument që Komisioni Europian ka përgatitur për komunitetin e biznesit në vendet anëtare të BE-së.

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës, si lider dhe koordinator i kapitullit të 8-të “Politika e konkurrencës”, është vlerësuar pozitivisht edhe në progresraportin e Komisionit Europian për vitin 2017. Sipas progresraportit, në fushën e politikës së konkurrencës, niveli i përgatitjes së Shqipërisë është i moderuar.

Në gjetjet e progresraportit evidentohet se kuadri ligjor është gjerësisht në përputhje me *acquis* dhe me dispozitat e MSA-së.

Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” është kryesisht në përputhje me nenin 101 për marrëveshjet e ndaluara dhe nenin 102, për abuzimet me pozitën dominuese të Traktatit të Funkcionimit të BE-së. Ai parashikon, gjithashtu, se kontrolli i përqendrimeve është në përputhje me Rregulloren e Përqendrimeve të BE-së.

Në progresraport evidentohet se legjislacioni sekondar është kryesisht në

përputhje me rregulloret përkatëse të BE-së dhe me udhëzimet e Komisionit Europian.

Duke filluar nga viti 2016 dhe në vazhdim, Autoriteti i Konkurrencës përdori procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve dhe rregulloren për procedurat e angazhimeve.

Në lidhje me kuadrin institucional, progresraporti vlerëson pavarësinë e institucionit tonë, si një autoritet, i cili raporton në mënyrë të pavarur në Kuvend. Anëtarët e tij zgjidhen nga Kuvendi.

Për sa i përket kapacitetit të zbatueshmërisë së ligjit, progresraporti vlerëson se niveli i ekspertizës së stafit të Autoritetit të Konkurrencës është forcuar në vite.

Në kuadër të zbatimit të rezolutës së Kuvendit për vitin 2016, Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar avokatinë e konkurrencës nëpërmjet promovimit dhe njohjes së programit të lehtësimit nga gjocat, duke synuar ndërgjegjësimin e bizneseve për përfitimet që vijnë nga ky program.

Megjithatë, ashtu siç evidentohet edhe në progresraport, për Autoritetin e Konkurrencës mbetet një sfidë zbatimin e programit për lehtësimin nga gjocat.

Autoriteti i Konkurrencës ka vazhduar gjatë vitit 2017 bashkëpunimin institucional me institucionet publike, në zbatim të dispozitave ligjore të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, prej të cilave është kërkuar paraprakisht vlerësimi ligjor për projektaktet normative, që kanë si objekt ose si pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizimeve sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Veçanërisht, ky bashkëpunim është realizuar me entet rregullatore, si: ERE-n, AMA-n, AMF-në dhe AKEP-in.

Ky bashkëpunim nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar me institucionet e tjera, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të Autoriteti i Konkurrencës kundrejt tyre, porë kjo edhe në fokus të moszbatimit të rekomandimeve të dhëna nga vendimet e Komisioni i Konkurrencës kundrejt këtyre institucioneve.

Autoriteti i Konkurrencës ka filluar gjatë vitit 2017 edhe procesin e rishikimit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Aktualisht, është duke realizuar një analizë të kuadrit ligjor, mbi bazën e krahasimit me legjislacionin e disa

vendeve të BE-së, si dhe evidentimin e problematikave që kanë dalë nga zbatimi i ligjit në praktikë.

Me miratimin e një projekti bashkëpunimi midis Autoritetit të Konkurrencës dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), të titulluar “Asistencë teknike për Autoritetin e Konkurrencës, rritje kapacitetesh, mbështetje për legjislacionin dhe avokatinë”, synohet mbështetja me një ekspertizë të specializuar, për të bërë të mundur rishikimin e ligjit, në drejtim të propozimeve konkrete, për shtesa dhe ndryshime në të.

Gjatë vitit 2017 Autoriteti i Konkurrencës realizoi vlerësimin e 22 rasteve të transaksioneve të njoftuara prej tij, nga të cilat 16 prej tyre kanë kaluar në procedurë vlerësimi dhe janë autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës dhe vetëm 6 prej tyre nuk i plotësonin kriteret e ligjit.

Të gjitha rastet e autorizuara kanë kaluar në procedura paraprake të vlerësimit dhe koha mesatare e realizimit të procedurës për vitin 2017 ka qenë afërsisht 24 ditë, në zbatim të udhëzimit “Për procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve” që, siç e thashë edhe më sipër, është një dokument plotësisht i përafuar me njoftimin e Komisionit Europian “Për procedurat e thjeshtuara në trajtimin e disa përqendrimeve.

Sektorët e ekonomisë me numrin më të madh të transaksioneve, të ndryshimit të kontrollit për vitin 2017, janë si më poshtë:

- Sektori i tregtisë me pakicë, me 8 raste të autorizuara nga Autoriteti i Konkurrencës, ku bën pjesë: tregu i importit të cigareve; tregu i importit dhe tregimit të duhanit të prodhuar nëpërmjet makinerive; tregu i prodhimit dhe i shitjes së ëmbëlsirave; tregu i prodhimit dhe shitjes të aparateve televizive LCD; tregu i shitjes së pajisjeve kompjuterike, *software* dhe *hardware*.

Tregu i dytë për nga madhësia, është sektori i telekomunikacionit, me 4 raste të ndryshimit të kontrollit, ku bën pjesë tregu i kalimit të frekuencave të telefonisë celulare; tregu i aksesit me shumicë dhe i origjinës së thirrjeve në rrjetet publike të lëvizshme; tregu i shërbimit Roaming dhe shërbimet e telefonisë fikse me shumicë për interoperatorët.

Sektori i tretë, është sektori financiar me tri raste, nga të cilat dy raste në tregun e shërbimeve bankare dhe një rast në tregun e sigurimeve.

I fundit, tregu i mjeteve motorike me 1 rast për instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturave motorike.

Nga vlerësimi i përqendrimeve rezultojnë se:

- 46% e rasteve të njoftuara janë transaksione, të cilat kanë ndodhur në tregun e jashtëm, 10 vendime autorizimi;

- 27% e rasteve të njoftuara janë transaksione, të cilat kanë ndodhur në tregun shqiptar, 10 vendime autorizimi;

- 27% e rasteve janë njoftime, të cilat nuk i kanë përmbushur kriteret ligjore për t'u autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës.

Transaksionet në tregun e brendshëm u referohen kryesisht:

- Tregut të telefonisë celulare, ku Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin e realizuar nëpërmjet transferimit të spektrit të frekuencave të ndërmarrjes "Plus Communication" të "Vodafone Albania" dhe tek "Telekom Albania".

- Tregut të sigurimit të jetës, ku Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit për shitjen dhe transferimin e kuotave të ndërmarrjes "INSIG Jete" nga "EUROSIG" të dy persona fizikë.

- Tregut bankar, ku Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së disa aseteve, detyrimeve dhe marrëdhënieve ligjore të ndërmarrjeve "Veneto Banca" nga "Intesa San Paolo Banca".

- Tregut të importit të cigareve, ku Komisioni i Konkurrencës autorizoi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të ndërmarrjeve që operojnë në këtë fushë.

- Tregut të shitjes së pajisjeve kompjuterike, software-ve dhe hardware-ve, ku përsëri Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë përqendrimin për sa u përket ndërmarrjeve që operojnë në këtë fushë.

Ndër transaksionet më të rëndësishme në tregun e brendshëm mund të përmendim atë të transferimit të spektrit të frekuencave nga "Plus Communication" të "Vodafone Albania" dhe tek "Telekom Albania".

Analizën e tij për këtë treg, Autoriteti i Konkurrencës e mbështeti në raste të ngjashme të ndodhura në tregun e telefonisë celulare, kryesisht në vendet e BE-së, si në Gjermani, Belgjikë, Austri, nga ku rezultoi se që nga viti 2010 tregu i telefonisë celulare është prekur nga reduktimi i numrit të operatorëve në këtë treg.

Komisioni i Konkurrencës me vendimin e tij nr. 485, datë 23.11.2017, krahas vendosjes së autorizimit të përqendrimit për kalimin e frekuencave të ndërmarrjes "Plus Communication" sh.a të "Vodafone Albania" sh.a dhe tek "Telekom Albania" sh.a, i rekomandoi autoritetit përkatës, AKEP-it, që ai të ketë detyrimin ligjor të sigurojë dhe të lejojë në të ardhmen frekuenca të lira për çdo hyrës të ri në treg.

Nga ana tjetër i rekomandoi AKEP-it që pas përfundimit të transferimit të spektrit, të bëjë një analizë të tregut të telefonisë celulare, duke përcaktuar Operatorin me Fuqi më të Ndjeshme në Treg (OFNT), në respektim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr.9918 i vitit 2008 "Për komunikimet elektronike dhe postare". Më pas, vetë Autoriteti i Konkurrencës, në bazë të këtij përqendrimi, të realizojë vlerësimin e tregut mbështetur në analizën e AKEP-it.

Aktualisht, jemi në fazën kur AKEP-i ka publikuar për këshillim publik dokumentin e analizës për tregun e telefonisë celulare, dhe së shpejti Komisioni i Konkurrencës do të shprehet me një vendim.

Po ashtu, tregu vazhdon të jetë në monitorim, dhe si rezultat i një vendimi të Komisionit të Konkurrencës, në shtator të vitit 2017, për mënyrën e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimit të telefonisë celulare dhe për dhënien e disa rekomandimeve, AKEP ka marrë vendim të rikthejë kohëzgjatjen e vlefshmërisë së paketave me parapagim nga 28 ditë në 30 ditë.

Gjatë vitit 2017, Autoriteti i Konkurrencës u përball edhe me procese gjyqësore. Nga 47 vendime të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës, vetëm njëri prej tyre është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, konkretisht vendimi që ka të bëjë me marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktivitetet e lidhura

me to për mallrat rifuxho në terminalin lindor të Portit të Durrësit.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, gjatë vitit 2017 janë gjykuar tri çështje, ku në dy raste Autoriteti i Konkurrencës ka qenë paditës dhe në një rast ka qenë i paditur.

Në Gjykatën Administrative të Apelit janë gjykuar dy çështje, kurse për vitin 2018 janë të mbartura 5 çështje të tjera.

Në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë kanë përfunduar 2 çështje dhe janë të mbartura 7 të tjera.

Të gjitha vendimet e Komisionit të Konkurrencës janë lënë në fuqi nga gjykatat përkatëse në të tria nivelet.

Në vitin 2017, veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës ka pasur në fokus edhe gjetjen e rrugëve për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve të marra ndër vite nga Komisioni i Konkurrencës.

Mund të themi se jemi në një rrugë të mbarë, pasi pas kërkesave të vazhdueshme të bëra nga ana jonë gjatë vitit 2017, Përmbartimi Shtetëror ka filluar të veprojë për vitin 2018, duke vënë në veprim dosje të cilat “fleenë në vite”.

Nga 13 raste të vendimeve të paekzekutuara, rezultojnë 2 raste të pezullimit të ekzekutimit të vendimit me vendim gjyqësor; në një rast është pranuar padia e palës debitore; një rast është në proces gjyqësor; në një rast kompania është *offshore*, dhe nuk ka llogari rrjedhëse në Republikën e Shqipërisë.

Për 8 rastet e tjera është vënë në veprim Përmbartimi Shtetëror, duke vendosur “sekuestro” për mjetet apo asetet në bankat e nivelit të II, duke bashkëpunuar me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar kjo në një shkresë të fundit drejtuar Autoritetit të Konkurrencës nga Zyra e Përmbartimit Tiranë, datë 19.04.2018, me titull “Informacion për veprimet e kryera në praktikat me palë kreditorë Autoritetin e Konkurrencës”.

Në rast se u referohemi penaliteteve të vendosura nga Autoriteti i Konkurrencës, në total është një detyrim në vlerën 498 milionë e 49 mijë e 307 lekë.

Nga ana e Përmbartimit është vjelur shuma 245 milionë e 747 mijë e 956 lekë, dhe ngelet për t’u vjelë edhe 51 % e shumës totale, vlerë e cila shkon në 252 milionë e 301 mijë e 351 lekë.

Krahas aktivitetit të tij në fushën e monitorimit, hetimit dhe vendimmarrjes, roli i Autoritetit të Konkurrencës është i lidhur ngushtë edhe me atë që quhet “formulimi dhe implementimi i politikave të tjera”, përkatësisht avokacia e konkurrencës.

Gjatë vitit 2017, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë në shqyrtim çdo vlerësim në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si me kërkesë të institucioneve propozuese, ashtu edhe me nismën e vetë, pra një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore.

Janë vlerësuar *ex-ante* 4 projektligje si vijon:

- Projektligji “Për sigurinë, ndërveprimin hekurudhor, si dhe për organizimin dhe funksionimin e autoritetit të sigurisë hekurudhore”;

- Projektligji “Për administruesin e infrastrukturës hekurudhore”;

- Projektligji “Për sipërmarrësin e transportit hekurudhor”;

- Projektligji “Për Shërbimin Meteorologjik dhe Hidrologjik Shqiptar”;

Po ashtu 3 projekt-akte normative në tregun e mediave audiovizive, si dhe mbi 30 akte normative në fushën e energjisë dhe të gazit natyror.

Në vlerësim të avokacisë së konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës, në bashkëpunim me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP-në) në datat 11-12 dhjetor të vitit 2017 organizoi konferencën e parë ndërkombëtare, e cila kishte në fokus 13 vjet eksperiencë të politikës së konkurrencës në Shqipëri, aspekte të ligjit, ekonomisë dhe biznesit, ku morën pjesë përfaqësues nga autoritetet homologe në Europë dhe SHBA.

Në lidhje me promovimin e kulturës dhe avokatinë e konkurrencës, Autoriteti zhvilloi disa tryeza të rrumbullakëta me komunitetin e biznesit, përkatësisht në tri qytete të mëdha: në Elbasan, në Fier dhe në Durrës, me temë “Kontributi i Autoritetit të Konkurrencës në zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve”, ku u paraqitën dy dokumente:

1. Programi i lehtësimit nga gjrobat.
2. Programi i përputhshmërisë me rregullat e biznesit.

Prezantimi i këtyre dokumenteve synoi ndërgjegjësimin e komunitetit të biznesit në

respektimin e rregullave të konkurrencës, si dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit të tyre me Autoritetin e Konkurrencës.

Në kuadër të politikës së konkurrencës, Autoriteti ka vazhduar procesin me kontributin e tij në kuadër të integritimit evropian, si një institucion lider për kapitullin e 8-të “Politika e konkurrencës dhe liberalizimi”.

Gjatë vitit 2017, ai ka vazhduar misionin e tij dhe, në kuadër të Planit Kombëtar për Integritimin Evropian (PKIE-ja) në terma afatmesëm, për vitet 2016-2017, Autoriteti ka realizuar përafrimin e dy akteve sekondare, përkatësisht rregulloren “Për kategoritë e marrëveshjeve të transferimit të teknologjisë”, si dhe broshurën informuese “Programi i përputhshmërisë me rregullat e konkurrencës”.

Viti 2017 shënon edhe një hov cilësor për sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar.

Autoriteti i Konkurrencës është bërë pjesë e rrjetit kombëtar të konkurrencës dhe aktualisht vepron në 5 grupe të këtij rrjeti:

1. Grupi i punës për avokacinë, (Advocacy Working Group);
2. Grupi i punës për efektivitetin e Autoritetit (Agency Effectiveness Working Group);
3. Grupi i punës për kartelet (Cartel Working Group);
4. Grupi i punës për përqendrimit (Mergers Working Group);
5. Grupi i punës për sjelljet e njëanshme në rastet e abuzimit të pozitës dominuese (Unilateral Conduct Working Group).

Po ashtu, mund të evidentojmë një bashkëpunim të frytshëm të Autoritetit të Konkurrencës me Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), si dhe me Qendrën Rajonale të Konkurrencës (OECD-GVH RCC).

Si rezultat i këtij bashkëpunimi të suksesshëm, për herë të parë Shqipëria, përkatësisht Autoriteti i Konkurrencës, është përzgjedhur si vendi pritës për të organizuar së bashku në Tiranë, nga datat 19-21 qershor seminarin me temë “Për kontrollin e përqendrimeve”, ku do të marrin pjesë përfaqësues nga 27 vende të Europës e më gjerë.

Viti 2017 u shoqërua edhe me ristrukturimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Kuvendi me vendimin nr. 43 të vitit 2017 miratoi strukturën e re, një strukturë e cila i përgjigjet zhvillimit ekonomik, si dhe dinamikës e larmisë së tregjeve, e përshtatur kjo strukturë edhe me modelet e vendeve europiane.

Një ndarje e drejtorive sipas tregjeve, një drejtori e re, pra drejtoria e analizës, si dhe një pozicion i ri, ai i “chief ekomist” janë pikërisht ato që i kanë mundur Autoritetit të Konkurrencës realizimin e analizave ekonomike dhe ekonometrike, në funksion të mirëfunksionimit të tregjeve.

Për vitin 2018 prioritetet e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës janë të lidhura ngushtë me atë që ne e quajmë “vendosja e rregullave të konkurrencës”, duke respektuar pikërisht këto rregulla në lidhje me mbrojtjen e interesave të konsumatorit dhe duke iu referuar përkatësisht atyre që konsiderohen tregje me problematika të përsëritura si: tregu i telekomunikacioneve, tregu i energjisë, tregu i hidrokarbureve, tregu financiar dhe ai i sigurimeve, si dhe tregu i agrobiznesit.

Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 69 të ligjit nr.9121/2003 do të forcojë bashkëpunimin me institucionet e administratës qendrore dhe vendore lidhur me vlerësimin për çdo projektakt normativ, që në mënyrë të veçantë ka të bëjë me:

- vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta;
- kufizimet sasiore për hyrjet në treg dhe tregtimin;
- imponimin e praktikave të njëjta me çmime dhe kushte të njëjta.

Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 70 të ligjit nr.9121/2003 do të bashkëpunojë me entet rregullatore në kuadër të rolit të Autoritetit për rregullimin dhe reformën rregullatore në sektorët e rregulluar.

Nga pikëpamja e përafrimit institucional, gjatë vitit 2018 është parashikuar që në kuadër të Planit Kombëtar për Integritimin Evropian 2017-2020, do të draftohen dhe miratohen dy udhëzues:

1. “Për kufizimet e drejtpërdrejta të lidhura dhe të nevojshme për përqendrimit”
2. “Për vlerësimin e marrëveshjeve në sektorin e telekomunikacioneve”

Autoriteti i Konkurrencës do të jetë përfitues i një projekti me Bankën Evropiane për

Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), në kuadër të bashkëpunimit me UNCTAD-në, Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin, pritet fillimi i një projekti që ka të bëjë me mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në fushën e konkurrencës, ku parashikohet një impenjim në lidhje me vlerësimin e të drejtave ekskluzive dhe të veçanta, një vlerësim i procedurave të prokurimit publik për marrëveshjet e ndaluara nën oferta, një vlerësim gjatë procedurave të kontrollit të përqendrimeve, si dhe shkëmbimet e eksperiencave.

Po ashtu, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson me përparësi obligimet ligjore, që i dalin nga Rezoluta e Kuvendit për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017, duke synuar funksionin e një konkurrence të lire dhe efektive në treg, me fokus:

- një bashkëpunimin konstruktiv me organet e administratës shtetërore dhe entet rregullatore;

- një monitorim në vazhdimësi i sjelljes së ndërmarrjeve, që u janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive dhe të veçanta, si dhe atyre ndërmarrjeve që kanë pozita dominuese në treg;

- të bëjë të mundur sigurimin e ekzekutimit të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës.

Së fundi, do të doja të falënderoja Komisionin e Ekonomisë, veçanërisht kryetarin e këtij komisioni, zotin Braçe, për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë dhe i jep Autoritetit të Konkurrencës në kuadër të instrumentit të ngritur nga Kuvendi për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit!

Mund të uleni!

Sipas Rregullores, a ka pyetje nga deputetët? Nuk ka.

Kërkesë për debat nuk ka. Atëherë, mbyllet kjo çështje dhe ngelet për t'u votuar rezoluta në fund të seancës.

Vazhdojmë me projektligjin “Për strehimin social”. Ka pyetje?

Po, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Jam këtu për t’ju kërkuar qartë dhe thjesht që ky projektligj të mos diskutohet sot, pasi

gjithçka që lidhet me të dhe procedimi janë krejtësisht në kundërshtim me vendimet që seanca plenare ka marrë.

Nuk besoj se ju do të legjitimoni që çdo vendim apo përçartje në komisionet përkatëse të kthehet në normë në Kuvendin e Shqipërisë për një arsye shumë të thjeshtë. Në seancën e datës 30 prill u mor në shqyrtim një propozim i dakordësuar mes maxhorancës dhe opozitës lidhur me çështjen në fjalë. Po jua citoj: “Duke marrë shkas nga diskutimet e zhvilluara në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve lidhur me shqyrtimin në seancë plenare të ligjit “Për strehimin social”, propozojmë...”, dhe propozuesit janë Taulant Balla dhe Fatmir Mediu, “...që projektligji në fjalë të hiqet nga rendi i ditës dhe shqyrtimi i tij të bëhet pas shqyrtimit të amendamenteve të opozitës, nëse do të ketë, në komisionin përkatës.” Ky komision përgjegjës, i cili është Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, refuzoi ta fusë në rendin e ditës, për ta bërë këtë detyrim që e përcaktoi seanca. Prandaj sot nuk mund të ketë absolutisht një diskutim të këtij projektligji, pasi do të thotë që seanca i kundërvihet seancës.

Meqenëse unë jua kam kërkuar këtë gjë edhe me shkrim, duke dokumentuar gjithçka, e cila nuk është as kapriçio, as ndonjë maniakalitet për këtë çështje, por thjesht dhe vetëm zbatim i vendimit të seancës, ju lutem shumë që kjo korrektesë të vazhdojë. Në të kundërt, do të thotë se vendimet e seancës janë nul dhe nuk janë më të detyrueshme për zbatim në të gjitha drejtimet që shkojnë.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Po, zoti Balla.

**Taulant Balla** – Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Për të qenë korrektë me të gjithë deputetët dhe deputetët e nderuara, unë dhe zoti Mediu, në mungesë të ndonjë përfaqësuesi tjetër të opozitës, në Konferencën e Kryetarëve kemi rënë dakord, sot e shtatëmbëdhjetë ditë më parë, meqenëse Konferencës së Kryetarëve dhe Kryetarit të Kuvendit u ishte drejtuar një kërkesë nga kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim që në seancën e Kuvendit, sot e dy javë përpara, meqenëse nuk kishte qenë e mundur që opozita të depozitonte amendamente, në frymë të plotë konsensusi, t’i



propozonim seancës, sot e dy javë përpara, heqjen e projektligjit në fjalë nga rendi i ditës.

Mendoj se dy javë kanë qenë tërësisht të dobishme dhe të mjaftueshme që çdo deputet i opozitës apo i maxhorancës, sikurse shoh amendamentet e depozituara nga deputetja Elona Gjebrea, t'i depozitonte amendamentet.

Kuvendi i Shqipërisë e ka të përcaktuar në Rregulloren e tij që deri 24 orë para seancës plenare çdo deputet ka të drejtën të depozitojë amendamente.

Sigurisht, në praktikën e konsoliduar 27-vjeçare apo 28-vjeçare të këtij Kuvendi, komisioni përgjegjës, në çdo rast, mbledhet edhe gjatë punimeve të seancës, për t'i shqyrtuar amendamentet, të kujtudo qofshin: të maxhorancës, të opozitës, të deputetit të thjeshtë ose të pavarur të Kuvendit.

Tani, në informacionin që unë kam dhe shoh përpara tryezës së deputetëve dhe kryetarit të grupit nuk ka asnjë amendament tjetër të depozituar, përveç amendamenteve të zonjës Gjebrea.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, unë dhe zoti Mediu e kemi firmosur këtë shkresë. Çfarë themi? Shqyrtimin e amendamenteve të opozitës në mënyrë të veçantë, nëse do të ketë”. Por mos merrni përsipër që unë t'ju shkruaj amendamentet ose zoti Mediu t'ju shkruajë amendamentet juve. Nuk e bëjmë dot këtë punë as unë, as zoti Mediu! Kemi lënë 17 ditë kohë për t'i depozituar.

Tjetër, projektligji “Për strehimin social” duhet të ishte shqyrtuar në Kuvendin e Shqipërisë më 25 shkurt. Sot jemi në datën 3 maj. Na është kërkuar dy herë nga ju, zoti Vasili, ta shtyjme, ta shtyjme, ta shtyjme, ta shtyjme, ta shtyjme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Të lutem shumë! Ky është një projektligj që për ne, socialistët, është shumë i rëndësishëm. Tundeni kokën sa të doni ju, por këtu po ndahet shapi nga sheqeri se kush e ka merakun tek oligarkët dhe kush nuk e ka merakun tek oligarkët! Oligarkët, nëpërmjet këtij ligji, 3% të çdo ndërtimi, do t'ua japin familjeve të pastreha!

Ky ligj, i nderuar zoti Kryetar i Kuvendit, i ka ezauruar të gjitha procedurat parlamentare. Kush ka dashur të depozitojë amendamente, e ka pasur mundësinë ta bëjë këtë.

Sipas parimit “një pro, një kundër”, zoti Kryetar, unë kërkoj procedimin normal të diskutimit të këtij projektligji dhe miratimin e tij në fund të seancës.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Po, zoti Mediu.

**Fatmir Mediu** – Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Duhet të vazhdoj, apo duhet ta sqarojë zoti Vasili?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Gramoz Ruçi** – Ju lutem, ju kërkuat që të hiqet nga rendi i ditës!

Njëri deputet e kundërshtoi, ndërsa zoti Mediu mund ta mbrojë; kaq përmban Rregullorja!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Si “u bë hataja”?! U bë hataja dhe të shkelen rregullat?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fjalën e ka zoti Mediu, që ka bërë kërkesën.

Urdhëroni, zoti Mediu, keni fjalën!

**Fatmir Mediu** – Zoti Ruçi, ne kemi rënë dakord të gjithë së bashku në Konferencën e Kryetarëve për rëndësinë që ka ky ligj. Rëndësia nuk është e socialistëve, e republikanëve, e demokratëve apo e LSI-së, por rëndësia është për qytetarët. Në diskutimin që kemi bërë të gjithë së bashku ka qenë ideja që ky duhet të jetë një ligj konsensual, pasi fryma e diskutimeve nëpër komisione ka qenë e tillë, madje u la afat kohor për të paraqitur amendamente.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së parashtron edhe një herë në Kuvend kërkesën për ta shtyrë këtë projektligj, për faktin se mbledhja e komisionit për të shqyrtuar amendamentet nuk është zhvilluar.

Për t'i qëndruar pikërisht asaj çfarë kemi diskutuar në Konferencën e Kryetarëve, rëndësisë që ka ligji dhe interesit që ka për qytetarët në nevojë, unë mendoj se është krejt normale që ne të vazhdojmë me të njëjtin qëndrim derisa të gjitha forcat politike ose edhe deputetë të veçantë të paraqesin, brenda afatit kohor, që mund ta caktojmë sot, të gjitha amendamentet e nevojshme për projektligjin, në mënyrë që të kalojë në cilësi dhe në vlerë, jo në interesin politik, por atij qytetar.

**Gramoz Ruçi** – Po, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Besoj se këtu nuk jemi për të bërë lojëra fjalësh. Zoti Balla e ka zgjedhur ta bëjë këtë punë dhe le ta bëjë. Ne jemi shprehur në mënyrë shumë të qartë që këto amendamente do të paraqiteshin në mbledhjen përkatëse të Komisionit të Shëndetësisë. Për këtë çështje, për ta ditur, komisioni u mbledh që t'i fuste në rendin e ditës, pra të mundësohej diskutimi i amendamenteve (flas për njerëz që e kuptojnë, që kanë kaq dije në kokë dhe nuk janë çmendur, aq sa të shtrembërojnë edhe shqipen).

Kjo mbledhje u refuzua, nuk u pranua. Me mospranimin e mbledhjes, ku do të paraqiteshin amendamentet? Nuk do t'ia çonim Taulantit me email amendamentet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo është kaq e qartë, kaq flagrante!

Rendi i ditës, me këtë propozim përkatës, u është nisur të gjithë anëtarëve të komisionit dhe në datën 30, në mbledhjen përkatëse, kjo mundësi, të cilën seanca e lejoi, u refuzua me votë.

Seanca nuk u shpreh që ne do t'i biem këto amendamente në sallë, por, meqenëse kishte një frymë të një konsensusi të arritur më parë, mundësoi që komisioni t'i shqyrtonte, pa pretendimin se komisioni do t'i miratonte, pasi është normale që edhe mund të mos i pranonte, por mundësia e shqyrtimit u lejua dhe u mundësua nga seanca.

Tani, ose ecën vendimi i seancës, ose ecën vendimi i Taulantit.

Në rast se është kundër, atëherë mos merrni më vendime seancash dhe thoni që këtë parlament e ka marrë lumi! Kaq!

*(Diskutime në sallë)*

**Gramoz Ruçi** – Këtu mbyllet çështja.

Ka një kërkesë të grupit parlamentar dhe kryetarit të komisionit për ta nxjerrë nga rendi i ditës, u shpreh një pro dhe një kundër. Kush është dakord me...?

*(Diskutime në sallë)*

Ju lutem, zoti Vasili!

Kush është dakord me kërkesën e zotit Vasili, për ta nxjerrë projektligjin nga rendi i ditës? Kundër? Abstenim?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk miratohet.

Vazhdojmë me seancën. Kush ka pyetje për projektligjin? Nuk ka.

Ministri nismëtar ka dëshirë ta parashtrijë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Ahmetaj, do ta parashtroni projektligjin?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Arben Ahmetaj** – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Projektligji “Për strehimin social” është reflektim i drejtpërdrejtë i vëmendjes dhe rëndësisë që qeveria, në mandatin e parë dhe të dytë të saj, i ka kushtuar mbështetjes sociale dhe mbështetjes së shtresave në nevojë.

Ky ligj është vazhdimësi e paketës së solidaritetit pikërisht me shtresat më në nevojë të popullsisë, që nuk preken njëlloj, në mënyrë të njëtrajtshme, nga zhvillimi ekonomik dhe në vazhdimësi të jetës dhe mirëqenies së tyre kanë pamjaftueshmëri ekonomike.

Për qytetarët është gjithmonë e rëndësishme të theksojmë të gjithë paketën sociale të qeverisë, duke filluar që nga taksa progresive. Mendoj se është një moment i mirë t'i përmendim një nga një të gjitha elementet.

Taksa progresive, përtej taksës, është një politikë sociale e drejtë, që, siç e thotë edhe Banka Botërore në raportin e fundit, uli pabarazinë dhe ktheu mbrapsht, në xhepat e qytetarëve shqiptarë, rreth 50 miliardë lekë ose 500 milionë dollarë në katër vjet.

Taksa zero e biznesit të vogël është patjetër, përtej taksës, një politikë sociale e drejtë dhe e duhur, nga e cila kanë përfituar rreth 80 mijë biznese. Vetëm nga prekjat, nga uljet e taksave për shtresat me pamjaftueshmëri ekonomike apo që nuk preken njëlloj nga zhvillimi ekonomik, kanë përfituar rreth 500 mijë familje në vend.

Statusi i minatorit, një betejë e gjatë ndër vite, kulmoi në vitin 2014 me uljen e moshës së pensionit, duke u kthyer dinjitetin dhe të drejtën e shumëkërkuar ndër vite.

Edhe për statusin e naftëtarit është ndjekur e njëjta logjikë. E njëjta paketë solidariteti shkoi në favor të mijëra naftëtarëve, që e kishin kërkuar shumë ndër vite këtë të drejtë të mohuar.

Një muaj më parë kemi bërë një debat për ndihmën ekonomike. Faktet e statistikave treguan se pagesa për ndihmën ekonomike është dyfishuar. 15 mijë familje, të cilat më parë

trajtoheshin me ndihmë ekonomike të pjeshme në masën 1 mijë lekë të reja në muaj, tashmë përfitojnë ndihmë ekonomike, në shumicën e rasteve, mbi mesataren prej 53 mijë lekësh të vjetra në muaj.

Subvencionimi dhe kompensimi i çmimit të energjisë elektrike apo subvencioni për arsimin është kthyer në të drejtë të konsoliduar. Mos harroni se më 1 janar të këtij viti ka hyrë në fuqi politika sociale, pjesë e paketës së solidaritetit, për dhënien e librave falas për nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e pestë. Sigurisht, edhe vaksinimi.

Vetëm brenda paketës së pensioneve, 118 000 000 dollarë shkojnë vetëm për kompensim të ardhurash për shtresat në nevojë. Ndërkohë, të mos harrojmë që për herë të parë në vend u vendos pensioni social, i cili, si koncept, është pjesë e paketës së solidaritetit, që është e domosdoshme për ato familje që nuk kanë të ardhura. Sot, përfitojnë pension social mbi 5500 qytetarë shqiptarë, të cilët, në një rast ekstrem, siç e gjetëm, do të ishin pa asnjë lek në xhep.

Në të njëjtën kohë ekziston edhe kategoria parësore e ish-të përndjekurve, që sërish kam kënaqësinë ta theksoj. Për ish-të përndjekurit janë dhënë tetë këste dëmshpërblim, një pagesë e plotë për ata që kanë vuajtur në regjimin komunist. Gjithashtu, në bazë të ndryshimeve ligjore që kemi bërë para 1 viti, janë duke u trajtuar rreth 250 dosjet e fundit.

Për sa i takon strehimit social, gjatë periudhës 2014-2017 janë akorduar nga buxheti i shtetit rreth 3,5 miliardë lekë apo 35 milionë dollarë.

Pra, siç e shikoni, paketa sociale dhe paketa e solidaritetit janë të konsoliduara, jo ad hoc, dhe traditë e kësaj qeverie. Nga këto paketa, rreth 550 milionë lekë janë investuar për përmirësimin e kushteve të banimit të banorëve të komunitetit rom dhe egjiptian, diferencë në subvencione për interesin e kredive, grant të menjëhershëm për persona me aftësi të kufizuar apo qira familjare për familjet e shpërngulura nga zbatimi i punëve publike. Vetëm para një jave Këshilli i Ministrave miratoi një paketë të re mbështetëse për familjet që janë shpërngulur nga pronat e tyre për shkak të ndërtimit të segmentit të rrugës Transballkanike, në Vlorë.

Për kujtesën tuaj, politikat e strehimit kanë filluar me miratimin e ligjit nr. 9232 të vitit 2004

“Për programet sociale të strehimit”. Deri në vitin 2013 kanë qenë vetëm dy programe: programi i banesave sociale me qira në tetë bashki të vendit, ky me bashkëfinancim të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës dhe programi i subvencioneve të interesave të kredive, për të cilin, më duhet ta them, nëse do të bëjmë një debat të detajuar, do të zbulojmë që ka pasur drejtpërsëdrejti abuzime nga njerëz të veshur me pushtet, të cilët e kanë përdorur atë fond për t’u dhënë shtëpi familjeve të veta, për shembull, në Sarandë. Në të njëjtin pallat jetojnë njerëz, të cilët kanë përfitur vetëm për shkak të influencës politike të më shumë se pesë njerëzve të veshur me pushtet, që janë edhe në këtë sallë.

Risitë e projektligjit.

Deri dje ka pasur kufizime ligjore për ato familje që nuk mund të përfitonin strehim social për shkak se nuk kishin të ardhura, sepse koncepti ka qenë që bashkia do të subvenciononte 50% të kostos së qirasë, por sot e kemi ndryshuar në ligj. Bashkitë me të ardhura të ulëta nuk kishin mundësi të akordonin fonde për strehimin, kurse buxheti i shtetit nuk mund t’i financonte, duke lënë kështu shtresat më në nevojë pa asnjë mundësi strehimi. Ky parim është korrigjuar në këtë ligj duke u dhënë mundësi familjeve pa të ardhura të përfitojnë drejtpërsëdrejti subvencion për qiranë e shtëpisë.

Projektligji parashikon parimet kryesore mbi të cilat mbështeten politikat dhe programet e banesave. Parimet e politikave të strehimit derivojnë nga e drejta për strehim të përshtatshëm. Pra, bazohen te kjo e drejtë, ashtu siç është shkruar qartë në Konventën për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, si dhe në Kartën Sociale Europiane. Ky është një hap i rëndësishëm në drejtim të trajtimit të strehimit, si një nga të drejtat e individit, e lidhur me të drejtën themelore të sanksionuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

Një nga parimet kryesore, që parashikon ligji, është siguria e qëndrimit, sipas së cilës, një individ apo familje nuk mund të dëbohet me forcë nga vendqëndrimi edhe atëherë kur ai apo ajo nuk ka një dokument të rregullt ligjor mbi pronësinë e qiramarrjes. Kjo nuk do të thotë se çdokush mund të zërë një mjedis dhe të qëndrojë në të pa u shqetësuar, por zhvendosja do të jetë në bazë të procedurave ligjore të parashikuara dhe të detajuara.

Parimi tjetër është kontributi i sektorit të ndërtimit për sigurimin e banesave sociale si pjesë e paketës së solidaritetit. Këtu jam i bindur që po davarit bolorinë politike të oligarkëve, që ju të anës së djathtë u referoheni. Është sindroma e kthimit në vendin e kriminit.

Kjo qeveri, që përfaqëson të majtën, dhe jo më kot numërova atë paketë të konsoliduar solidariteti, për herë të parë po vendos një parim të shkruar në ligj, ku çdo ndërtues do të kontribuojë për strehimin social me 3% të metrave katrorë që do të ndërtojnë, që nga hyrja në fuqi e këtij ligji e më tej. Ju flisni për oligarkë dhe kulla, por sektori i ndërtimit do të vendosë 3% të metrave katrorë ndërtim në favor të komunitetit që ka nevojë për strehim social. Mund ta kishit bërë ju më parë, të ishit përballur me ne, por po e bëjmë ne. Fakti është që kjo maxhorancë dhe kjo qeveri e ka paketën e solidaritetit në ADN-në e vet, por asnjëherë për emocione apo referenca elektorale.

Ky është një argument që e kthen mbrapsht me ironi, te ju, në anën e djathtë, bolorinë politike të oligarkëve. 3% e të gjithë ndërtimit do të dorëzohet në favor të njerëzve në nevojë. Në Tiranë, sipas llogaritjeve që kemi bërë dhe planifikimit të ndërtimeve, përgjatë 3 vjetëve të ardhshme, familjeve që kanë nevojë për strehim social do t'u vihen në dispozicion 45 mijë metra katrorë ndërtim. Kjo gjë po bëhet për herë të parë, sepse nuk është bërë asnjëherë.

Natyrshëm dhe në legjitimitet, komuniteti i ndërtuesve ka reagimin e vet. Logjika e kostos. Për këtë arsye Kryeministri ka ndërmarrë një iniciativë për të riparë strukturën e taksës së infrastrukturës me dy parime: shfrazimin në kohë të pagesës dhe njohjen e shpenzimeve që ata kanë për infrastrukturën e ndërtimit që bëjnë, me qëllim për t'iu afuar të gjitha qasjeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Nëse dikush thotë që kjo është shpikje, unë ju them që nuk është shpikje. Nuk kemi shpikur rrotën me kontributin dhe paketën e solidaritetit për sa i përket strehimit social. Në mënyrë absolute, jo. Për shkak të përgjegjësisë, kemi kopjuar mirë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat e kanë në traditën e tyre mbështetjen e drejtpërdrejtë për strehimin social, apo nga Britania, që i kemi referuar në mitin politik si e djathtë. Ajo ka një politikë të strehimit social të konsoliduar, duke prekur dhe

mbështetur pikërisht shtresat më në nevojë. E njëjta gjë ndodh në Spanjë, Itali, Francë dhe tani ne po e kthejmë në politikë edhe në Shqipëri.

Pra, nuk është gjetje. Ka qenë aty kur kemi qenë ju në pushtet dhe është aty edhe tani që jemi ne në detyrë, por ne kemi përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë për ta parë në sy problemin. Vetëm në Bashkinë e Tiranës do të vendosim 45 mijë metra katrorë ndërtim në favor të shtresave që kanë nevojë për strehim social për shkak të pamjaftueshmërisë së të ardhurave. Kjo është diferenca. Nuk kemi bërë gjetje apo shpikje, por me përgjegjshmëri, zemër dhe mendje kemi bërë një kopjim të kujdesshëm në favor të njerëzve që kanë nevojë për strehim social. Patjetër që nuk është e mjaftueshme. Ky është një problem që nuk mund të zgjidhet brenda një dite, viti apo mandati qeverisës, por ama është një përpjekje drejtpërdrejtë e prekshme sado që ju, për arsye politike, e sulmoni. Një nga arsyet pse e shtytë këtë ligj në komision, ishte pikërisht se nuk donit që të përballeshim këtu me konceptin, që ju thoni: oligarkët, oligarkët, oligarkët. Kjo është ajo që bën e majta dhe një maxhorancë e përgjegjshme.

E theksoj përsëri që 45 mijë metra katrorë ndërtim në 3 vitet e ardhshme nuk janë të mjaftueshme dhe nuk e shpëtojnë dot atë shtresë të shoqërisë shqiptare që nuk ka mundësi të blejë apo marrë me qira banesë nga tregu, por ama e ka një zgjedhje.

Së dyti, dua të ndaj me ju një iniciativë, tashmë të avancuar dhe duke u diskutuar deri në detaje financiare, të Kryeministrit për mbështetje strehimi për çiftet e reja, të cilën mendojmë se do të kemi mundësi ta iniciojmë në mes të mandatit.

Pra, në ditën e parë të vitit të tretë të mandatit të dytë, do të kemi mundësi të nisim një politikë mbështetëse për strehimin e çiftëve të reja.

A janë të mjaftueshme? Jo, të gjitha sa kemi bërë nuk janë të mjaftueshme. Ato që kemi bërë kanë qenë të mjaftueshme për ta larguar Shqipërinë nga skenari grek, i lënë qëllimshëm prej jush. E kishit kalkuluar mirë, por nuk kishit kalkuluar vetëm një gjë, përgjegjshmërinë e kësaj qeverie dhe kësaj maxhorance. Pra, kanë qenë të mjaftueshme për të na larguar nga skenari grek, por nuk janë akoma të mjaftueshme dhe nuk do të jenë kurrë të mjaftueshme për të arritur atë që qytetarët me të drejtë aspirojnë.

Shpesh u referohemi ndjesive politike. Çdokush thotë që është i pakënaqur nga qeveria. Patjetër që do të jetë i pakënaqur nga qeveria, sepse maxhoranca e majtë përfaqëson aspiratën europiane, që është e ardhmja, prandaj, kur i referohemi duke thënë se me të djathtën ka më keq, me të majtën asnjëherë nuk është mirë, sepse ka gjithmonë më mirë. Kjo është paketë solidariteti e konsoliduar dhe do të vazhdojë të jetë në ADN-në e kësaj maxhorance.

Faleminderit!

*(Drejtimitin e seancës e merr zonja Hysi.)*

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Ministër!

Sipas nenit 74\1 të Rregullores, kryetari i komisionit përgjegjës, zoti Vasili, ka të drejtë të marrë fjalën.

**Petrit Vasili** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Për dy arsye të mëdha, nuk kam ndër mend të ndalem më në thelbin e këtij projektligji.

Për këtë projektligj ka pasur një frikë të tmerrshme për ta diskutuar. Ka pasur frikë të madhe nga përmirësimi, pasi ka qenë një ligj për dijeninë e të gjithë shqiptarëve, se ministri ndoshta nuk e di, që në 90% të tij është arnuar në rrugë e sipër.

Së dyti, nga pikëpamja e procedurës parlamentare, për t'u njohur të gjithë dhe për ta zgjidhur sot: a do të ketë më një procedurë parlamentare minimalisht normale, se nuk po kërkohet më shumë se kaq, për të reflektuar formalisht një procedurë të rregullt? Edhe raporti që e shoqëron këtë projektligj tashmë, por ta quajmë ligj, se ju do ta votoni, nuk diskutohet, është "marrosur" kaq shumë saqë edhe debatet, që kanë qenë në komision, argumentet e dhëna, qoftë nga maxhoranca, qoftë nga opozita, që është minimumi i çdo relacioni, nuk i reflekton. Kjo ka ndodhur nga histeria për ta shkruar sa më parë dhe për të dhënë një provë, që ne e duam shumë qeverinë dhe po i japim dhuratën e radhës. Ky është një raport nul, sepse është një raport që ka devijuar dhe e ka deformuar atë çfarë ndodhi në komisionin përkatës, si detyrim që t'u vihet në dispozicion deputetëve. Të vendoset të votohet si të dojë, por këtë detyrim e ka edhe në bazë të Rregullores, edhe të procedurave minimale parlamentare, pa të cilin ky konsiderohet një akt i manipuluar.

Të jemi shumë të qartë: është manipuluar raporti i komisionit përkatës. Merrreni lexojeni! Ky duhet të ishte shqetësimi madhor për të gjithë.

Për sa u takon, edhe një herë tjetër shpjegimeve për diskutimin, meqenëse ligji kishte 90 e ca për qind ndryshim, arnuar nga të gjitha krahët, qëllimi i mirë ishte të qartësonim në ligj, të reflektonim edhe mballomat pa fund, shumë propozime të grupeve të interesit, si edhe ta fusnim në një procedurë parlamentare normale ashtu siç kishte filluar dhe falë së cilës kishte pasur edhe dakordësi politike.

Është hera e parë që në këtë parlament, po jua theksoj, shihet një maxhorancë që trembet edhe nga konsensusi. Kjo nuk është dëgjuar ndonjëherë! Trembet nga konsensusi! Konsensusi u dha edhe me votë, edhe në parim. Frika e tmerrshme nga korrigjimi është prekje e interesave. Unë dëgjova edhe ditirambe për oligarkët. Tani ta kursejmë këtë. Edhe ministri Ahmetaj të na e kursejë këtë budallallëk tani. Jepen qindra milionë lekë koncesione, u kemi dhënë leje ndërtimi të bëjnë qindra kulla atje, dhe po u marrim 50 metra katrorë! Por nuk janë për ne këto! Këto janë dëngla që nuk jua beson njeri! 100 kulla në Tiranë! Por një pjesë e këtyre ka ardhur vonë në Tiranë, nuk tremben pse po u japin 100 kulla, se po marrin 50 metra dhe do t'u japin qindra milionë euro që t'i fitojnë, pavarësisht se çfarë thotë edhe Departamenti Amerikan i Shtetit se po pastrohet paraja në mes të Tiranës dhe në mes të gjithë Shqipërisë. Dhe na e shesin si luftë kundër oligarkëve. Këto janë për ata njerëz që kanë qejf t'ju dëgjojnë ju, thujauani përsëri! Mos na i thoni neve, na refuzoni!

Veç kësaj, Kryetari të Kuvendit i jam drejtuar qartë dhe i kam thënë ( se nuk i kam kërkuar të hiqet dhe të shtyhet ligji. Ky është një manipulim publik që Gramoz Ruçi mori përsipër ta bëjë këtu në sallë), ia kam kërkuar me shkrim dhe jo me fjalë, pasi janë gënjeshtarë profesionistë dhe nuk mund të komunikohet ndryshe, që të vazhdojë të shqyrtohet në komisionin përkatës ditën që u mor vendimi, duke pasur të gjithë kohën për ta bërë këtë gjë në mbledhjen e Komisionit për Çështjet Sociale. Pra, e thënë me pak fjalë, këtë parlament kanë vendosur ta rrënojnë edhe politikisht, edhe proceduralisht.

Por cila është arsyeja? E shqetëson ky parlament. I shqetëson çdo lloj debati. Meraku i vetëm janë monologjet idiote, me të cilat qeshin me njëri-tjetrin, gëzohen përsëri, kurse fukarenjtë atje janë po mysybet siç kanë qenë, pavarësisht nga lufta e tmerrshme qesharake, butaforike që u bëhet oligarkëve, se do t'u merren 50 metra katrorë. Besoj se shqiptarëve këtë lloj budallallëku dhe këtë lloj hipokrizie të tmerrshme mund t'ua kursejmë duke u thënë që ato qindra kulla po i anulojmë, meqë duam të luftojmë oligarkët, heqim edhe pastrimin e parave që e thotë Amerika, nuk e thotë opozita, se kanë merak të madh këta, se mos e thotë opozita, u heqim të gjitha ato koncesione që u kemi dhënë, që janë qindra milionë. Pastaj, meqë kanë merakun e 50- metërshit, t'ua japim. Po 50 metra katrorë me 500 milionë euro, vetëm matematika e Benit mund ta zgjidhë më mirë nga të tjerët.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Vasili!

Sipas nenit 74 të Rregullores komisionet për dhënie mendimi janë Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese. Kanë të drejtën e 10 minutave secili.

Më parë i jap fjalën ministrit Ahmetaj.

**Arben Ahmetaj** – E dëgjova me vëmendje, si zakonisht, zotin Vasili, shpresova si dikur të ishte pozicionuar majtas, dhe potencialisht me vëmendje për shtresat në nevojë dhe se do ta mbështeste projektligjin, por ditën kur flasim për strehimin social, iu referua keqlexueshmërisë, që i bën vetë raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit.

Të 3 raportet e fundit flasin për ndryshime rrënjësore në të gjitha fushat e jetës. Nëse doni, do t'i referohem progresraportit, që rekomandoi hapjen e negociatave. Ishte ëndërr e keqe për ju, ëndërr e mirë për shqiptarët. E keni vendosur veten përballë shqiptarëve. Gjithë shqiptarët donin hapjen e negociatave. Ju e kishit ëndërr që të vinte këtu Mogerini dhe të thoshte: “Më fal! Nuk i hapim negociatat, ose i hapim me kusht, se kështu ka thënë Luli, kështu ka thënë x-i, kështu ka thënë y-i”. Nuk ndodhi kjo, më vjen keq!

Raportet kanë nënvizuar zhvillimet politike, ekonomike, institucionale, madje edhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve. E kam theksuar dhe e theksoj, kemi diferencë. Nëse ju thosht: “Jemi të

dytët pas Gjermanisë”, ne themi me modesti: “Ne bëmë atë që bëmë, lamë pas skenarin tuaj grek të përllogaritur me kujdes”. Ne jemi po në modesti të plotë kur numërojmë ato që janë bërë dhe gjithmonë themi se kurrë nuk janë mjaft. Është diferencë e madhe të thuash: “Ne jemi të dytët pas Gjermanisë” dhe të vish të thuash me modesti para shqiptarëve: “Po, nuk kemi bërë mjaft, do të bëjmë akoma më shumë”. Janë dy botë të ndryshme.

Miku im, të del detyrë të vish të votosh ligjin, se dikur ke qenë i majtë, sot (ndoshta keni humbur busullën, nuk e di, nuk e marr përsipër, por ke qenë dikur i majtë), hajde dhe mbështete këtë ligj, është në nderin tënd!

Faleminderit!

**Vasilika Hysi** - Faleminderit, zoti Ministër!

Kalojmë në listën e diskutantëve. Secili diskutant ka të drejtë të flasë 10 minuta. Fjalën e ka deputeti Edmond Spaho.

Të përgatitet Elisa Spiropali.

**Edmond Spaho** – Të nderuar qytetarë,

Sikur ky të ishte i vetmi problem që ka mbetur pa zgjidhur në Shqipëri, sigurisht do t'i kushtonim ca kohë dhe do ta gjenim një zgjidhje.

Dje pamë Kryeministrin, që filloi një tur të dhënies llogari te qytetarët, por veçse dhënie llogarie nuk kishte në atë që ai ndërmori. Po të shikojë fjalorin e Kryeministrit, të dukej sikur ishte në vitin 2013, ku sapo kishte marrë pushtetin dhe vazhdonte me retorikën e tij të premtonte: shëndetësi falas, ulje të taksave për 95 % të shqiptarëve, rrugë, ujësjellës, kanalizime, rritje të pagave, rritje të pensioneve dhe punë për të gjithë.

Sot, pas 5 vjetësh në qeveri, Kryeministri ynë vazhdon dhe merret me zgjidhjen e punësimit të një apo të dy militantëve të PS-së, ndonjëherë edhe të PD-së, dhe harron t'u thotë qytetarëve se çfarë është bërë me taksat. Përse janë rritur kaq shumë? Përse ka arritur në 5 vjet të rëndohet buxheti i familjeve të qytetarëve shqiptarë me 500 milionë euro? Përse qytetarë shqiptarë nuk kanë punë? Pas 5 vjetësh që premtoi zhvillim ekonomik dhe që do ta bënte Shqipërinë vendin kampion të rajonit, sot qytetarët shqiptarë largohen përditë e më shumë në emigracion. Të na shpjegojë pse i kanë ikur në 5 vjet 200 mijë shqiptarë në emigracion. Përse Shqipëria është bërë vendi i dytë, pas Sirisë, që ka luftë, për emigrantët që i çon Europës? Nuk u

shpjegoi qytetarëve shqiptarë partneritetin publik-privat, të famshmin, me të cilin po i merr të gjitha paratë e buxhetit të shtetit dhe po ua jep oligarkëve dhe kastës që ka rrotull vetes. Po ngarkon qytetarët e vendit të tij të paguajnë për ato fonde që ia jep këtij takëmi, siç veptoi me Rrugën e Kombit, kur vendosi taksën 5 euro dhe u kërkoi njerëzve ta paguanin, sepse me të do të ushqehen oligarkët e pangopur të tij. Nuk na tha asnjë fjalë për borxhin që shkoi 72%, bashkë me koncesionet shkon në 80%, se kush do të paguajë, sa do të vuajnë brezat që do të vijnë njëri pas tjetrit, për të përballuar këtë barrë të madhe, të cilën po ua jep kontrabandistëve, kriminelëve, oligarkëve të këtij vendi që i ka mburojë të pushtetit të tij?

Nuk na tha një fjalë Kryeministri për raportin e Departamentit të Shtetit, që e nxjerr simbolin e krimit dhe të korrupsionit qeverisjen e tij, në çdo qelizë, në palcë të shtetit dhe krimi e korrupsioni janë bërë një me shtetin. Nuk dallon ku fillon krimi dhe ku mbaron qeverisja, pasi Edi Rama dhe të gjithë kriminelët, trafikantët e drogës, oligarkët, i gjen të renditur dhe të rreshtuar këtu, pavarësisht fytyrave se kush është ministër.

U kapën dje 2,5 tonë drogë. Në kohën kur po propagandohet me të madhe se lufta ndaj drogës ka arritur suksese të jashtëzakonshme. Iku periudha kur Shqipëria ishte vendi që eksportonte drogë, e kemi zgjidhur, i kemi marrë të gjitha masat, e kemi ngritur të gjithë shtetin në këmbë. 2,5 tonë u kapën dje në Itali. Ky është rezultati?! Po a mund të na thotë ndonjëri nga ju: çfarë u bë me 613 kilogramë kokainë? U harrua kokaina. As një muaj nuk ka kaluar dhe çështja është futur nën rrogë. Kush u kap? E kujt ishte? E atyre magazinierëve? Ata e sollën nga Kolumbia? Ky është efektiviteti i luftës? Nuk ka sesi të ndodhë ndryshe kur kryetrafikanti dhe simboli i qeverisjes suaj lëviz, brendi i lirë, hyn dhe del në Kuvend, nuk ka sesi të ndodhë ndryshe kur del dhe jep konferencë shtypi, nuk ka sesi të ndodhë, kur nuk luftoni drogën dhe ai vjen dhe kërcënon Kryeministrin dhe thotë: "Nuk ka bir kurve dhe burrë nëne të më pengojë mua në luftën ndaj të vërtetës!". Cila është e vërteta? E vërteta është që janë të dy të lidhur. Nuk po e akuzon opozita, opozita e ka akuzuar me vite të tëra, por sot ai është në këtë pozicion si kryetrafikant dhe simbol i Edi Ramës për

shkak të prokurorisë së Italisë, të Katanjës. Është i kapur me presh në duar, i regjistruar. Nuk ka mundësi të kanabizohet e gjithë Shqipëria vetëm me Saimir Tahirin, është Saimir Tahiri dhe Edi Rama. Nuk ka mundësi të mbytet Europa me drogë pa u lidhur krimi i organizuar dhe trafikantët e drogës me qeverinë.

Shteti dhe trafikantët janë bërë një, prandaj dhe Shqipëria është kthyer sot në delen e zezë dhe nuk na i hapin negociatat për anëtarësim. Sot në komedinë e radhës, në farsën e radhës, Saimir Tahiri në emër të Edi Ramës, thotë se do të lërë mandatin. E lë mandatin, thotë. Mirë, po a nuk erdhi këtu para një jave për të mbrojtur mandatin? A nuk erdhi këtu, në Kuvend? Çfarë ka ndryshuar? Apo shkoi zotëria në Berlin, ku ia vunë të dyja këmbët në një këpucë dhe i thanë: ose do të hyjë në burg Saimir Tahiri, ose nuk ka hapje negociatash. Dhe fillojnë tani nga komedirat dhe nga lojërat e radhës, për të mbrojtur Saimir Tahirin e për të mbrojtur Edi Ramën, duke bërë sikur po i heqin mandatin.

I bëri presion para dy javësh, pavarësisht lojërave që po bëjnë sot. Sot i bëri prapë presion. Domethënë, po bëj sikur po jap dorëheqjen dhe po e lë mandatin, por ki kujdes, se dikush më tha mua: përse nuk deklaroni se kontrabandisti më i madh i drogës është Edi Rama? I bëri presion edhe me ministrin e Brendshëm, që i tha: je kontrabandisti më i madh deri më sot.

Sigurisht, kur janë të përzierë kaq shumë, që nga Kryeministri, ish-ministri i Brendshëm, ministri i Brendshëm, ministra të tjerë, nuk ka si të ndodhë që ju t'ia jepni Saimir Tahirin drejtësisë. Nuk ka si t'ia jepni drejtësisë, sepse, në radhë të parë, jeni të interesuar të mbronni Edi Ramën. Po të ishte thjesht Saimir Tahiri, do ta kishit bërë kurban me kohë, por ai pati zgjuarsinë të mbledhë ca dosje, që sot t'ia tundte Edi Ramës dhe qeverisë së tij, që po më latë mua, do t'i nxjerr këto, sa s'do të keni ku të futeni dhe do t'ju shkojë pushteti në gropë. Prandaj jeni vënë të gjithë në rresht sot këtu, duke mbrojtur Tahirin, sepse kështu mbronni Edi Ramën, mbronni pushtetin tuaj, mbronni veten tuaj.

Sigurisht, sot ju mund ta jepni mandatin, ta falni, nuk ju duhet, sepse jeni të pastër si qelibar, dhe nuk keni frikë të shkoni te drejtësia, por pasi i prishët punët. Katër muaj, pesë muaj i prishët të gjitha provat e hetimit. Sigurisht, pasi e liruati Orest Sotën, i humbi të gjitha gjurmët, pasi ikën

ata tre oficerët e policisë në emigracion dhe pasi e çuat Nazer Seitin në Itali, që të mos ketë mundësi të deponojë. Tani bëni një farsë tjetër, që na jepni imunitetin e Sajmir Tahirit me deklarata. Sado farsa të organizoni, komuniteti ndërkombëtar ju ka njohur me dhëmb e dhëmballë, dhe pa hyrë në burg Sajmir Tahiri nuk ka për të pasur hapje të negociatave.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Sado që të përpiqet, nuk do t'ia arrijë dot...

*(Ndërhyrje nga salla)*

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Spaho!

Fjalën e ka kërkuar Kryeministri.

**Edi Rama** – Profesor, njerëzit ikin, fjala mbetet, kështu që ne vazhdojmë me fjalën që mbeti pas. Prania juaj, kuptohet, nuk i shton asgjë seancës.

Profesori më dha mundësinë të flas për llogaridhënien publike. Besoj se fjalët e profesorit duhet t'i kemi parasysh si një hapje e çdo seance të llogaridhënies publike në të gjithë territorin, sepse, në fund të fundit, profesori përfaqëson të gjithë mendimin më të kualifikuar të një opozite të pakualifikuar.

Pse ne sot e kemi domosdoshmëri fushatën e llogaridhënies publike? Sepse aty ku zakonisht, në një vend ku demokracia funksionon me një shumicë që qeveris dhe me një opozitë që i kërkon llogari, pra në Kuvend, neve nuk na kërkohet llogari. Ne thjesht na hidhen gurë, topa balte e gjithfarëloj llozhrash të mbledhura në tërë hapësirën e dëshpërimit të kësaj opozite.

Nga ana tjetër, për ne, fushata e llogaridhënies do të jetë një konstante e çdo fundviti të këtij mandati, sepse ne kemi marrë përsipër të qeverisim me njerëzit dhe për njerëzit. Kemi kërkuar një mandat për të punuar në drejtimin e vendit, pa qenë të shoqëruar nga askush prej këtyre që na lanë shëndenë, po për të qeverisur në një koalicion me njerëzit. Fushata e llogaridhënies është e rëndësishme edhe për faktin se ne duhet të jemi të drejtpërdrejtë, sy më sy në komunikimin me njerëzit, pa lejuar që këtë komunikim ta zotërojnë agjentët e mjerimit, të gjithë ata që me mandat politik apo me kanale mediatike në dispozicion, të bëjnë deformimin, shtrembërimin dhe manipulimin e të vërtetave tona, e të vërtetave tona të thjeshta, që janë të lidhura me çka kemi bërë mirë e me çka duhet të bëjmë më mirë.

Profesori iu referua rekomandimit. Iu referua po ashtu edhe një raport të Departamentit Amerikan të Shtetit. Është e bërë e modës që raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit t'i dëgjojmë të interpretuara për së pari nga simotra jonë e humbur në drejtim të paditur, Lëvizja Socialiste për Integrim.

Kemi edhe shokun tonë këtu, Luanin e LSI-së, i cili mezi pret të dalë e të na informojë në lidhje me çka thotë Departamenti Amerikan i Shtetit për ne. Por nuk ka qenë e largët dita kur raportet e Bashkimit Europian kishin në faqet e tyre emra dhe mbiemra, jo fenomene, por emra dhe mbiemra.

Kryetari vulëhumbur i kësaj opozite ka qenë me emër e mbiemër në raportin e progresit; jo si hero i progresit, por si pengesë për progresin.

Një tjetër kryetar i një simotre të simotrës së simotrës, ka qenë me emër e mbiemër në raportin e progresit. Edhe ai, jo si një dëshmor i progresit, por si një pengesë e progresit.

Sot ne kemi një raport progresi të Komisionit Europian, që nuk është vetëm një raport i radhës, por është një dokument që mbështet hapjen pa kushte të negociatave për anëtarësim të Shqipërisë.

E arritëm këtë. E arritëm këtë jo vetëm duke luftuar për progresin, por dhe duke luftuar për të kapërcyer çdo ditë kodrat dhe malet me baltë, që kjo opozitë eksporton në zyrat europiane, ku flitet për Shqipërinë.

Profesori këtu, me të gjithë kompetencën që e karakterizon, dhe si të ishte një njeri që nuk gdhijej e ngrysej nën qiellin pa çati të SHQUP-it, por gdhijej e ngrysej në kancelarinë gjermane, tha se pa u futur në burg Sajmir Tahiri, na paska thënë Gjermania, këtu s'ka të ardhme për Shqipërinë. Profesori! Ndërkohë që pjesa e vetme e diskutimit në komisionin e Bundestagut për të shpjeguar lidhur me Shqipërinë, ishte pjesa ku unë dëgjoja gjermanisht ato që kemi dëgjuar këtu shqip për katër vjet.

Sepse është normale. Për një parlamentar, për një grup parlamentarësh në Gjermani apo në Europë, është shumë e vështirë të arrijnë në atë nivel kuptimi që duhet të ketë një i huaj, kur ndeshet me baltën e eksportuar nga Tirana. Është shumë e vështirë të arrijë në atë nivel kuptimi, duke qenë edhe një grusht miqsh të këtyre, që të besojnë se këta janë baba i rrenës dhe nëna e



shpifjes, e se historitë e këtyre nuk kanë lidhje me të vërtetën.

Sidoqoftë, në fund, e vërteta është se në asnjë rast e për asnjë arsye, një vend anëtar i peshës së Gjermanisë, nuk mund të jetë kurrë një burim budallallëqesh, siç është kjo opozitë e përfaqësuar sot, me dinjitetin e vet më të lartë të mundshëm, nga profesori.

Ne morëm rekomandimin pozitiv për çeljen e negociatave pa kushte, ne kemi marrë një dëftesë, që asnjë nga këta profesorë apo çirakë të bashkuar në emër të popullit, nuk e konteston dot, sepse Komisioni Europian është një makineri analizash e gjykimesh jo mbi llafet, jo mbi broçkullat, jo mbi tymin e ngritur përditë mbi kokat e shqiptarëve për interesa politike mizerabël, por është një makineri që gjykon objektivisht çfarë u bë, çfarë s'u bë, sa u bë, si u bë dhe çfarë duhet bërë më tutje. Me këtë dëftesë në dorë, Shqipëria sot është në një pozicion që nuk ishte deri përpara marrjes së kësaj dëftese. Me këtë dëftesë në dorë, Shqipëria sot provon se nuk ka lidhje me çfarë thonë këta. Dhe, për më tepër, shqiptarët, të cilët i njohin mirë këta, nuk rrëmbehen, siç mund të rrëmbehet normalisht një deputet i huaj kur gjendet përpara gjithë asaj balte, dhe është i detyruar të thotë: "Çfarë bëhet? Çfarë ndodh?"

Shqiptarët i kanë provuar këta. I kanë provuar që të gjithë me radhë. Njërin palë e kanë provuar për vite të tëra, palën tjetër e kanë provuar edhe me njërin, edhe me tjetrin në dy martesat dhe kanë parë që janë ata që janë. I kemi, do t'i mbajmë, por do t'i mbajmë këtu ku janë gjithmonë e më pak të besueshëm e të dëgjueshëm. Le të vazhdojnë! Problemi ynë nuk janë këta. Për këta, Partia Socialiste rri 1 mijë vjet në pushtet. Këta Partisë Socialiste nuk i afrohen dot në asnjë formë, në asnjë rrugë. E dinë, por janë si ai personazhi i filmit që, kur kalonte pyllin, këndonte këngë partizane që të trembte hijet e frikës, që i dukeshin si gjermanë. E dinë këta.

Problemi ynë është si të bëjmë më shumë, në kushtet kur nuk kemi opozitë, si të bëjmë më mirë, në kushtet kur nuk na sfidon opozita. Një opozitë me vizion, me program dhe me ide, një opozitë që vjen këtu, e përgatitur për të goditur aty ku të dhemb, dhe, duke të goditur aty ku të dhemb, të prekë interesin e njerëzve për atë çfarë njerëzve u dhemb, është shumë më e vështirë,

por është edhe shumë më motivuese. Kurse një opozitë që për vizion ka baltën, program ka dyqanin e çizmeve dhe të miellit, ide ka kush gjuan më fort dhe kush shan me zë të lartë, është vari llamarinën! Për ne, arsyeya që jemi këtu, janë njerëzit.

Nga ana tjetër, në 6 muaj kemi marrë rekomandimin pozitiv, kemi vënë përfundimisht në lëvizje vetingun e shumëpritur dhe të shumëpënguar nga të gjithë këta, disa mbi dhe e disa nën dhe, disa në çadër e disa mbi çadër. Nuk e kthejnë dot më mbrapa. Janë dy momente madhore të së ardhmes së vendit, jo të së sotmes, dhe janë dy arritje të cilat nuk na i heq dot askush. Ashtu sikundër ne duhet të flasim me njerëzit për t'ua thënë në sy dhe për t'i pyetur në sy se cilat taksa u janë rritur. Po të dëgjosh këta, këta flasin këtu sikur nuk bëjnë asgjë gjithë ditën, vetëm paguajnë taksa nga mëngjesi deri në mëngjesin tjetër, dhe vijnë të enjten që të shfryhen sikur po paguajnë shumë taksa.

Cilat taksa janë rritur për njerëzit? Duhet me durim t'ua komunikojmë. Kush ankohet për rritjen e taksave? Ankohen ata që nuk kanë paguar kurrë taksa dhe ngatërrojnë pagesën e dritave me taksat, pagesën e ujit me taksat, apo ngatërrojnë faktin që sot paguajnë një taksë që deri dje nuk e paguanin. Ankohen dhe ata të tjerë, që nuk e bëjnë dallimin mes taksave kombëtare dhe tarifave vendore dhe ne duhet t'ua shpjegojmë.

Dy taksa kemi rritur ne. Kam kaq kohë që pyes, por nuk vijnë të ma thonë të tretën, duke përjashtuar atë të duhanit, kuptohet. Atë unë nuk e konsideroj fare në këtë rritje taksash, sepse atë e kemi një taksë shumë të thjeshtë. Lër duhanin dhe e ke zero taksën! Dy taksa kemi rritur ne. Kemi rritur taksën për më të pasurit, qofshin kompani, qofshin persona, që fitojnë më shumë. E kemi rritur pasi e kemi premtuar, e kemi rritur konform programit dhe konform filozofisë sonë. 10% e kishin kompanitë, e kanë 15%. 10% e kishte Kryeministri dje, sot e ka 15%. E ka më lart, jo 15%. Kemi bërë rritje progresive të taksave për ata që fitojnë më shumë. Vjen profesori këtu dhe thotë 98%. Jo 98%, por 97%. Pra, 97% e shqiptarëve paguajnë më pak taksa. Kemi rritur edhe taksën e karburantit. E kam shpjeguar dhe do ta rishpjegoj pse e rritëm taksën e karburantit.

Në shtatorin e vitit 2013, kur kemi marrë votëbesimin në Kuvend, kemi marrë në dorë një vend që ishte në buzë të greminës, në prag të zjarrit, njësoj si në Greqi. Saliu nuk gënjente kur thoshte: “Prisni, se ju pret skenari i Greqisë.” Ai e dinte mirë se çfarë na kishte lënë. Kishte lënë një humnerë përpara.

Sollëm FMN-në, zjarrfikësin ndërkombëtar, për të shmangur flakët mbi financat e shtetit. FMN-ja na e tha shumë qartë: “Ulni rrogat, ulni pensionet, sepse ndryshe nuk do të keni mundësi t’i paguani, kështu siç i keni, në fund të nëntorit dhe në dhjetor.” Ne nuk pranuan t’i ulnim, por duhet të nxirrnim para për buxhetin. Mes shumë taksave që u diskutuan në atë kohë, ne vendosëm të rrisim taksën e karburantit, për të mos vendosur një taksë të re për të gjithë, por për të vendosur një taksë për konsumatorët e karburantit, duke u nisur nga fakti që çmimi kishte rënë pikiatë dhe ajo që ata do të nxirrnin, dhe e kanë nxjerrë deri më sot nga xhepi, ishte dhe është më pak sesa paguanin për karburantin, kur ishte me çmimin e lartë ndërkombëtar. Patjetër që çmimi është më i lartë sesa ai në rajon. Sigurisht që e dimë, por është më i ulët sesa ishte. Janë 100 milionë dollarë çdo vit që me çmimin e vjetër do të shkonin për karburant dhe, sot, me gjithë taksën brenda, mbeten në xhepin e konsumatorëve të karburantit. Ky është fakt.

Këto dy taksa kemi rritur. Plus që në çmimin e karburantit është edhe taksa e qarkullimit. Cilat janë taksat e tjera?

Ah, po! Bashkia e Tiranës ka rritur taksën për ndërtesat dhe ka bërë shumë mirë. Përsëri për më të pasurit bëhet fjalë.

Cilat janë taksat e tjera kombëtare, që paskemi rritur ne? Profesori thotë se para 5 vjetëve u paskemi premtuar njerëzve se do të rrisnim rrogat dhe nuk i kemi rritur. I kemi rritur rrogat më shumë sesa i kanë rritur këta në 8 vjet. Ky është fakt. Të ardhurat e punonjësve në shtet apo në privat, që kanë një rrogë deri në 600 mijë lekë, janë sot më shumë edhe për shkak të rritjes së rrogës, edhe për shkak të uljes së taksës. Mësuesja sot paguan më pak taksa sesa dje. Një infermier sot paguan më pak taksa sesa dje dhe i kanë rrogat më të larta sesa dje. Duhet më shumë? Patjetër që duhet më shumë, por, po të kthejmë kokën pas, ishin këta.

A ka shqiptar të cilit i funksionon rradakja e palidhur me sistemin e prodhimit të energjisë së SHQUP-it apo të LSI-së, që mund të mendojë se ka krahasim këtu dhe mund të kthehet pas?

A ka shqiptar që nuk e ka prizën e rradakes te muret e SHQUP-it apo te kolibja e LSI-së, që mund të mendojë se këta janë për t’u dëgjuar, e jo më pastaj për t’u besuar? Nuk ka. Por kjo nuk na mjafton, se ne nuk e kemi garën me këta. Ne duam të shkojmë më tutje, në *Champions League*. Ne nuk luftojmë për kategorinë e dytë dhe të tretë. Këta janë kategoria e dytë, Titi me Luanin janë e treta, kjo dihet. Dhe si të gjithë ata të kategorisë së tretë, rrinë dhe, kur u vjen topi në këmbë, nuk shohin topin, shohin këmbën e tjetrit. Për këtë e mbajnë topin, që të na gjuajnë këmbëve, jo që të bëjnë gol, se dihet që Titi dhe Luani nuk kanë lidhje fare me zonën e rreptësisë, se aty është Monika me çizme në dorë për t’i gjuajtur arbitrit.

Çfarë të bëjmë? Përpiqet njeriu t’i marrë seriozisht, për të respektuar ata që i kanë votuar. A merren seriozisht këta? A mund ta marrësh seriozisht Titin?! Si ta marr seriozisht? Unë bëj përpjekje, se e kam edhe gjysmëpatriot për atë zonë. E thashë si bisedë meqë e pashë që po buzëqesh i lumtur si gjithmonë në fund të rreshtit.

Profesori thotë: “Tregojuni shqiptarëve për koncesionet!” Patjetër, për këtë do të shkojmë në llogaridhëniet publike, për t’u treguar shqiptarëve nga afër dhe me intensitet, jo thjesht nga sa na jepet mundësia përmes televizionit, se si këta i kanë rrjepur me koncesione dhe si ne paguajmë para nga buxheti, që shqiptarët të marrin shërbime më të mira, pa u thënë të paguajnë më shumë. Kjo është diferencë shumë e thjeshtë.

Titi nuk e do *check up*-in. Mendon se është i tepërt. Ka qenë edhe ministër i Shëndetësisë. Kjo është çështje e Titit. Për Titin, Shqipëria që kishim, ishte më e mirë sesa kjo që kemi. Për ne, Shqipëria që duam, duhet të jetë shumë më e mirë sesa kjo që kemi. Ky është dallimi. *Check up*-i është falas. Sigurisht që ne paguajmë për të, por nuk u themi shqiptarëve, siç u thoshte Titi, kur ishte ministër i Shëndetësisë: “A doni të bëni *check-up*? 82 mijë lekë e keni.” Nuk u themi këtë njerëzve. Ose: mos e bëni, vrisni veten! Pra, 82 mijë lekë e kishte, meqë fjala na çoi tek Titi, se, në fakt, është më mirë të përqendrohemi

te profesori, se është si është, por është mbi Titin.

Në kohën e profesorit dhe të Titit operacionet bëheshin akoma me instrumentet që kishte sjellë i ndjeri Enver, në kohën e dashurisë shqiptaro-kineze, të pasterilizuara sipas standardeve dhe me një numër marramendës infeksionesh postoperatore. Shikojini sot shifrat e infeksioneve postoperatore! Ato flasin qartë. Sigurisht, është një koncesion, por ne, nënave që shkojnë të lindin fëmijë, nuk u themi: “Ne kemi sjellë instrumente të reja dhe duhet të paguani për lindjen.” As familjarëve që çojnë njerëz për të operuar nuk u themi: “Meqë hoqëm ato të ndryshkurat e Titit, dhe kemi sjellë këto nga Gjermania, do të paguani një tarifë”. Në asnjë mënyrë! Shërbimin ata e marrin siç e merrnin, pra nuk paguajnë. Patjetër, për këtë paguan shteti, se kur themi shërbime shëndetësore falas, nuk themi shërbime që vijnë si rezultat i një marrëveshjeje që ne kemi bërë me Zotin, i sjell Zoti nga hapësirat e veta të pafundme dhe këto ndodhin. Jo, janë shërbime falas për qytetarët, por që i paguan shteti, i paguan shoqëria.

Ata me dializë, profesori dhe Titi i linin rrugëve, me tri turne. Tri herë në javë vinin në Tiranë. Dhe ku e bënin dializën? Te privati, por te një privat i vetëm. Sot e bëjnë dializën në kushte krejtësisht të tjera, e bëjnë në zonën afër qendrës së tyre të banimit dhe nuk detyrohen të paguajnë edhe për familjarin që i shoqëron për të ardhur tri herë në Tiranë, ditën dhe natën dhe të torturohen si të ishin qenie pa asnjë vlerë. Këto janë koncesionet që kemi bërë ne.

Profesori thotë: “Oligarku i Rrugës së Kukësit, Shefqet Kastrati”. Oligarku ynë! Profesorin ndoshta nuk e kanë informuar për kontributet e Çetit për Partinë Demokratike. Saliu dhe Luli i dinë mirë.

Në gjithë këtë vorbull, që krijohet këtu çdo të enjte dhe në të gjitha vorbullat që krijohen ditë për ditë nëpër banakët e televizioneve, ku shfaqen këta agjentët e mjerimit, që kanë marrë përsipër të shpëtojnë popullin, ne jemi të detyruar të jemi shumë më pranë njerëzve dhe të flasim shumë më tepër. Sigurisht, ne do të themi çfarë kemi bërë, por jemi të parët që e dimë se duhet të bëjmë më shumë. Ne jemi të parët që e dimë se gjërat nuk janë në rregull dhe ka shumë për të rregulluar. Ne jemi të parët që e dimë se ku pikon çatia. Këta nuk dinë gjë fare. Këta janë

në autobusin e dasmës, që shoqëron kamionët e miellit dhe furgonët e çizmeve. Këta janë në botën e tyre.

Kjo ishte replika ime me profesorin.

Sigurisht, si në çdo fjalë apo në çdo replikë me figura serioze si profesori, përdoren edhe ilustrime nga jeta dhe, për këtë, këtë herë përdora Titin.

Shumë faleminderit!

*(Duartrokite në sallë)*

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Kryeministër!

Po, zoti Rama, për replikë, 2 minuta.

**Luan Rama** – I nderuar zoti Kryeministër, Meqenëse patët mirësinë të më referoheshit, ju dëgjova me shumë vëmendje.

Meqë ju paska bërë kaq shumë përshtypje që dje thashë apo lexova çfarë ka thënë Departamenti Amerikan i Shtetit për ju dhe qeverinë tuaj, më lejoni t’ju bëj një sfidë!

Në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit, të vitit 2016, që i referohet vitit 2015, për Shqipërinë thuhet: “Shqipëria nuk figuron në vendet e listuara dhe të verifikuara për pastrimin e parave”.

Ndërkaq, 1 vit më parë kam thënë në këtë parlament dhe në këtë foltore, atë çfarë thoshte në atë kohë raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, pra, në vitin 2017, për vitin 2016. Raporti thotë shprehimisht apo tekstualisht këtë që po citoj: “Shqipëria figuron ndër vendet problematike për pastrimin e parave”.

Ndërkohë, në raportin e këtij viti, i publikuar pak javë më parë, që i referohet vitit 2017, thuhet tekstualisht kështu: “Shqipëria mbetet një rrezik i madh, për shkak të pastrimit të parave të pista, kjo për shkak të korrupsionit të shfrenuar dhe institucioneve të dobëta ligjore dhe qeveritare”.

Nëse nuk është kështu në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit, unë iki nga ky parlament, zoti Kryeministër.

Më provoni të kundërtën e kësaj që sapo thashë, që është qëndrimi zyrtar i Departamentit Amerikan të Shtetit për qeverinë tuaj, zoti Kryeministër!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Rama!

Fjalën e ka kërkuar për replikë zoti Vasili.

Keni 2 minuta kohë, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – E nderuara drejtuese e seancës,

Unë tani e bashkëndaj këtë profesionin e gjithologut, që ka marrë përsipër të bëjë Kryeministri, edhe me të gjysmologut, sepse kush do t'i bëjë të gjitha, siç mendon se i bën ky, gjysma-gjysma i bën. Megjithatë, më shumë respekt, jo për këtë, se kur ky nuk e ka zgjidhur me veten këtë problem, nuk ia zgjidh dot unë, për ta ditur dhe për t'ia ndritur pak injorancën, se për shëndetësinë këtë e tallin sa ngopen të gjithë, ngaqë e dinë që ky nuk merr vesh, ata ia thonë dhe ky i thotë: Në Shqipëri, or ti mik, është bërë para se të vije ti kardiokirurgji, neurokirurgji, kirurgji e përgjithshme, parandalim,... ka pasur 98% të mbulimit me vakcina. Shqipëria ka qenë vend lider në imunizimin evropian, para se të vije ti. Këto nuk janë bërë as me ata hanxharët hipotetikë, që të japin në mendje fantazmagorira, s'janë bërë as me ato të ndryshkurat që të kanë thënë ty, që të tallin dhe të gënjejnë. Teknologjinë e lartë që ke, e ke gjetur, nuk e ke blerë. Një spital të ri nuk bërë dot. Nuk po të thotë gjë njeri. Aq e ke fuqinë, aq i lodhur je! Puna jote!

Kam një këshillë shumë të mirë, miqësore, për aq sa ka mbetur për t'ua njohur bashkë: mos fol më për shëndetësinë, se gajase të gjithë ata që merren me këtë punë!

Se çfarë shëndetësie është bërë me ty, si ka qenë kur kam qenë unë dhe para 70 vjetëve, e dinë të gjithë, nuk ka mbetur ta shpjegosh ti!

E di si je bërë kur flet për shëndetësinë? Më keq se Adhamudhi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Vasili!

Fjalën e ka deputetja Elisa Spiropali.

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)*

Zonjë, erdhët me vonesë. Ka folur zoti Petrit Vasili.

Më fal! E kam njoftuar zonjën kohë më parë. Ju nuk ishit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)*

Po, pra ka folur zoti Petrit Vasili i pari.

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)*

**Elisa Spiropali** – E nderuara drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Që opozita nuk ka ardhur këtu për të folur për strehimin social, është e kuptueshme, sepse po u rrënohet shtëpia, streha e tyre politike. Tavani ka rënë, dyshemeja nuk i mban më, muret janë plasaritur, boja u ka dalë... Kështu që është krejt e kuptueshme edhe nga ana jonë, që në këtë

follore të mos flitet për strehë, por që ne të tjerët duhet të flasim për një nga projektligjet më të rëndësishme të kësaj maxhorance, kjo është e padiskutueshme!

Çdokush ka të drejtën e një standardi jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin. Kjo është deklarata universale e të drejtave të njeriut, por është një realitet i largët, jo vetëm këtu, por edhe në shumë vende të tjera të botës.

Në 2009-n isha kandidate për deputete në listën e Tiranës dhe mbuloja njësinë nr. 8, zonën informale të kësaj njësie. Për ata që e njohin, nga ish-restorant Durrësi, deri te Bregu i Lumit. Në një nga takimet në këtë zonë, te Bregu i Lumit, takova një vajzë të vogël, rreth 7 vjeçe (për koincidencë emrin e kishte Elisa), e cila nuk fliste më. E ëma më tha se e kishte humbur të folurin dhe refuzonte të fliste, sepse shtëpinë ua kishte marrë lumi. Edhe librat, të cilët ia kishte dhuruar një kishë aty afër, nuk mund t'i përdorte më. Edhe ato ia kishte marrë lumi. Nuk kishte asnjë mundësi tjetër për të shkuar në shkollë. Refuzonte të fliste. Ishte një zgjedhje apo një mundim i madh, këtë nuk e di, por si ajo vajzë, kudo nëpër Shqipëri, në komunitetin rom, egjiptian dhe jo vetëm, ka shumë, me mijëra.

Kemi qenë të gjithë dëshmitarë se si nxirreshin njerëzit nga shtëpitë e tyre për ndërtime të veprave publike, por pa asnjë kujdes për jetën e tyre më pas, sepse një ligj i tillë tërësor nuk ka ekzistuar. Për mungesë të kujdesit apo të vizonit, që është treguar në 27 vjet, unë nuk e di, por ky është fakt.

Kemi parë njerëz të dalin nga shtëpitë e tyre për t'ua liru vendin ish-pronarëve apo të tjerëve në të drejtën e tyre, ama të mbetur pa shtëpi; fëmijë, të cilëve prindërit u janë vrarë në detyrë; të pastrehë.

Ky projektligj zgjidh me themel çështjen e strehimit për familjet dhe individët në nevojë dhe për të gjitha shtresat sociale.

Projektligji u jep akses për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm familjeve në nevojë, të varfërve, duke u kushtuar vëmendje masave konkrete, me qëllim promovimin, mbrojtjen dhe sigurimin e plotë e progresiv të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Objektivi i këtij projektligji është vendosja e rregullave, e proceduarve, e modaliteteve

administrative për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim.

Referuar kreut III të projektligjit (dhe duhet ta theksoj), përfitues janë të gjithë individët dhe familjet në Republikën e Shqipërisë.

Gjej rastin, që nga Kuvendi i Shqipërisë, t'u bëj thirrje individëve për ta lexuar, për t'u informuar për këtë ligj, i cili i vë ata në kushtet e një aplikimi të drejtë, jo përpara administratorëve apo funksionarëve politikë, të cilët në mbledhjet e këshillit bashkiak jepnin (ndoshta edhe japin) shtëpi për familjarë të tyre, siç ndodh në shumë bashki dhe denoncimet janë të shumta, apo për njerëz të lidhur me ta, për taraf apo për kushërinj, për njerëz që nuk janë në nevojë dhe kanë të vetmen meritë, që janë familjarë apo janë në partinë e funksionarëve publikë.

Ky projektligj e ndryshon këtë turp kombëtar, duke përcaktuar modalitete të sakta për aplikimin për strehim.

Merr statusin e përfituesit nga programet sociale çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

Nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore, i zhvendosjeve, për shkak të investimeve publike, për shkak të përjashtimit të objektit nga procesi i legalizimeve, nga zbatimi i akteve administrative dhe nga zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë;

familjet që kanë një banesë të vjetër në rrezik shembjeje ose kanë një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj.

Projektligji përfshin si përfitues nga programet e strehimit social edhe shtetasit e huaj me qëndrim të rregullt në Shqipëri, punëtorët emigrantë apo azilkërkues.

Projektligji synon të mundësojë një qasje të përshtatur për disa kategori shoqërore: personat me aftësi të kufizuara; të moshuarit; fëmijët; individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore deri

në moshën 30 vjeç; familjet e mbetura të pastreha, për shkak të lirimit të banesave të tyre; emigrantët e rikthyer; punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit; familjet e policëve të rënë në detyrë; punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë; punonjësit e repartit RENE; viktimat e dhunës në familje; viktimat e trafikimit; viktimat e mundshme të trafikimit; anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian; të miturit në konflikt me ligjin, pas ekzekutimit të dënimit; vajzat nëna; njerëzit e diskriminuar për shkak të orientimit seksual, duke lehtësuar shkallën e plotësimit të nevojave të veçanta të strehimit të këtyre komuniteteve.

Projektligji është një bazë e mirë për zhvillimin e programit të strehimit me kosto të përballeshme për grupet në nevojë. Ai ofron një shumëllojshmëri instrumentesh dhe programesh financiare, që mund të zbatohen për të mbështetur qasjen në strehimin e grupeve në nevojë. Kombinimi i ligjit kundër diskriminimit me këtë projektligj ofron, gjithashtu, mbrojtje nga diskriminimi në ndarjen e banesave dhe përmirësime të tjera strehimi për minoritetin rom dhe egjiptian.

Nisma ligjore përmbush disa prej objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të "Axsendës 2020-2030" të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, të adaptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Besoj se objektivi kryesor është i dallueshëm, sepse deri në vitin 2030 sigurimi i aksesit për strehim adekuat është i sigurt, i përballeshëm dhe me shërbime bazë për të gjithë. Gjithashtu, është edhe përmirësimi i lagjeve të varfra, duke qenë se projektligji parashikon edhe rindërtimin e shtëpive, që janë në kushte të papërshtatshme për të jetuar apo janë të rrënuara.

Projektligji parashikon parimet kryesore mbi të cilat mbështeten politikat dhe programet e banesave sociale. Ndër parimet risi, me ndikim të drejtpërdrejtë te qytetarët, veçoj: parimin e sigurisë së qëndrimit, duke ndaluar në çdo rast dëbimin, si dhe duke ofruar garanci për individët dhe familjet, të cilat preken nga procesi i zhvendosjes; parimin e respektimit të kulturës dhe traditave të komuniteteve, ku njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë përgjegjësi për

planifikimin e zonave të banimit dhe programeve të strehimit.

Gjej rastin të falënderoj ish-ministren e Zhvillimit Urban, zonjën Gjermeni, e cila e ka çuar përpara këtë ligj, duke bashkëpunuar dhe duke u konsultuar me shumë grupe interesi, por edhe me organizma ndërkombëtarë të interesuar. Ky projektligj është ndoshta nga më të diskutuarit në vend, ku ndërthuren qasja e programeve sociale të strehimit me shërbimet sociale të tjera si: punësimi, strehimi, shëndetësia dhe ato të ngjashme me to.

Gjithashtu, dua të theksoj edhe procesin e gjatë të diskutimit në Komisionin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë me prezencën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila nuk ka munguar asnjëherë në këto takime, duke na sjellë propozimet e saj.

Në fund, po jo për nga rëndësia, çdo subjekt privat që investon ose kryen ndërtime në territorin e Republikës së Shqipërisë, me sipërfaqe mbi 2 mijë metra katrorë, duhet të kalojë 3%-in e ndërtimit për banesa sociale. Besoj se ky është thelbi i projektligjit dhe është një nga praktikatat më të mira të vendeve si Spanja, Irlanda apo Italia, të cilat, sigurisht, e dinë se ata, që kanë përfitime më të mëdha, duhet të japin më shumë për komunitetin. Ata që flasin për oligarkët nga mëngjesi deri në darkë duhet të vijnë këtu dhe ta votojnë këtë projektligj.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja Spiropali!

Fjalën e ka deputeti Luan Rama.

Të përgatitet deputetja Elona Gjebrea.

**Luan Rama** - E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Kolegë deputetë,

Më lejoni t'ju ftoj që të keni vëmendje, pasi do t'ju bëj të njohur një shkelje flagrante të ligjit nga ana e Kryeministrit, nga ana e qeverisë dhe nga ana e Kuvendit.

Duke përfituar nga rasti, që ju që drejtoni seancën jeni edhe juriste, jam i bindur se do të më kuptoni drejt në të gjitha referencat që do të sjell dhe do ta konsideroni këtë një akt xhentilese dhe kortezie nga ana ime, për ta ndihmuar në këtë rast qeverinë dhe jo për të hedhur baltë, qoftë edhe në kuptimin metaforik të termit, sepse balta asnjëherë nuk ka pasur lidhje me performancën, sjelljen apo qëndrimet e mia politike dhe publike.

Konkretisht, jemi përballë faktit që Kryeministri i vendit jo vetëm nuk e ka krijuar, por e ka penguar krijimin e Komitetit Kombëtar të Bashkëndimit të Luftës Kundër Drogës, ç'ka është detyrim i nenit 3 të ligjit nr. 8750, datë 26 mars 2001, i ndryshuar më 10.02.2011 dhe 15 shtator 2016 "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike dhe psikotrope".

Zonja drejtuese e seancës, merreni ligjin dhe në nenin 3 të tij do të gjeni shprehimisht këtë fjali: "Krijohet Komiteti Kombëtar i Bashkëndimit të Luftës Kundër Drogës nën drejtimin e Kryeministrit. Komiteti mbledhet të paktën dy herë në vit dhe ka për detyrë të përcaktojë drejtimet e politikës së përgjithshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të parandalimit dhe të luftës kundër prodhimit dhe përhapjes së paligjshme të substancave të sipërpërmendura; të promovojë fushata për të bërë të njohura efektet negative të drogës, masat e parandalimit, asistencën shëndetësore dhe të dhënat epidemiologjike dhe statistikore, rehabilitimin dhe integrimin e toksikodipendentëve e të tjerë". Në përbërje të këtij Komiteti janë pothuajse të gjithë ministrat, që të mos i përmend, dhe bashkë me ta edhe prokurori i Përgjithshëm dhe drejtori i Shërbimit Informativ.

Vazhdojmë më tej, në nenin 5 të ligjit thuhet: "Komiteti Kombëtar i Bashkëndimit nëpërmjet Kryeministrit, që është kryetari i këtij Komiteti, brenda datës 30 mars të çdo viti i paraqet Kuvendit një relacion me të dhënat, që kanë të bëjnë me paraqitjen e dukurisë së drogës në Shqipëri, me strategjitë e përshtatura, me objektivat e arritura dhe orientimet e ardhshme të qeverisë për detyrimet ndërkombëtare".

Ky raport, zonja drejtuese e seancës, nuk i ka ardhur Kuvendit nga Kryeministri dhe ka një muaj që Kryeministri dhe Kuvendi janë në shkelje të këtij ligji. Ky nuk është i vetmi ligj që, në fakt, nuk gjen zbatim, por ky është një ligj, moszbatimi i të cilit sjell konsekuenca të mëdha në luftën kundër drogës dhe në funksionimin e institucioneve, që kanë detyrë dhe përgjegjësi ligjore kushtetuese ta ushtrojnë këtë lloj veprimtarie, pra, të luftojnë trafikun e drogës.

Natyrisht, unë e di se ju do të gjeni disa referenca, disa statistika, disa shifra, që, në fakt, janë për t'u konsideruar, sepse unë nuk bëj pjesë

ndër ata që nuk e vlerësojnë dhe nuk e çmojnë punën që bën Policia e Shtetit, por ky ligj nuk ia atribuon luftën kundër trafikut të drogës vetëm Policisë së Shtetit, por një tërësi institucionesh. Pra, është një hallkë e tërë e ndërveprimit, bashkëveprimit dhe bashkërendimit të këtyre institucioneve, që duhet të çojë tek ato rezultate që presin, në radhë të parë, qytetarët shqiptarë dhe pastaj partnerët tanë ndërkombëtarë.

Komiteti Kombëtar i Bashkërendimit të Luftës Kundër Drogës është i vetmi autoritet përgjegjës që administron të dhënat, që harton dhe orienton politikën, që ndjek zbatimin e tyre, që nxjerr përgjegjësinë dhe që ia sjell më pas Kuvendit si informacion të gjithë këtyre realitet. Mbi këtë bazë ndërtohet i gjithë rrjeti i partneritetit, qoftë edhe i informacionit që institucionet e shtetit shqiptar kanë me institucionet, trupat apo mekanizmat ndërkombëtarë të luftës kundër trafikut të drogës. Kur them “luftën kundër trafikut të drogës”, kam parasysh të gjithë zinxhirin e akteve të veprimtarisë kriminale, që janë derivate ose produkt i të njëjtës qasje kriminale, e cila, në mos sponsorizohet, më së paku favorizohet edhe për shkak të mozhbatimit të ligjit, por edhe për shkak të faktit që Kryeministri nuk e ka krijuar Komitetin Kombëtar të Luftës Kundër Drogës.

Nuk po e them për herë të parë, të njëjtin shqetësim e kam ngritur edhe para një viti dhe madje më është thënë: “Faleminderit!”, sepse në atë kohë ne ishim bashkë në qeveri, më është thënë: “Faleminderit për vërejtjen dhe do të reflektojmë menjëherë!”. Mirëpo, unë nuk jam aq i pamoralshëm sa t’i trajtoj kolegët, partnerët, bashkëpunëtorët politikë me përçmim dhe t’u sjell atyre në vëmendje se sa herë janë martuar, dy apo tre herë e më shumë, sepse nuk e quaj etike, as korrekte t’u përmend të tjerëve numrin e martesave për shkak të paaftësisë apo për shkak të komplikacioneve të tjera.

Meqenëse e konsideruat baltë atë që thoshte Departamenti Amerikan i Shtetit, më lejoni t’ju sjell edhe një referencë tjetër që është përsëri brenda së njëjtës qasje, realiste dhe kritike, që ka Departamenti Amerikan i Shtetit. Në rastin konkret po ju citoj raportin e vitit 2018 të Byrosë së Sigurisë Diplomateke të Departamentit Amerikan të Shtetit, i publikuar, gjithashtu, pak ditë më parë për Shqipërinë. Ja çfarë thotë ky raport, të nderuar kolegë: “Departamenti

Amerikan i Shtetit e ka vlerësuar Tiranën si një vend të rrezikshmërisë së lartë për krime, që prekin interesat e qeverisë amerikane. Krimi i organizuar vazhdon të jetë një shqetësim për shumicën e shqiptarëve me një rrjet organizatash kriminale, të përfshira në trafik lëndësh narkotike, grabitje, ryshfete, pastrim parash, prostitucion dhe trafik qeniesh njerëzore”.

Ky raport është i vitit 2018 dhe është i një agjencie prestigjioze. Ky raport u shkon të gjitha ambasadave, përfaqësive dhe njësisë diplomatike të SHBA-ve në të gjithë botën.

Natyrisht, mund ta konsideroni baltë edhe këtë, por nuk besoj se ka donjë njeri, që di të arsyetojë në ato parametra optimale, sa për t’u quajtur njeri i përgjegjshëm, që qëndrimet e institucioneve të partnerëve tanë strategjikë, që skanojnë dhe i bëjnë të njohur opinionit realitetin shqiptar, të konsiderohen baltë mbi Shqipërinë. Nëse është baltë, kjo është balta që keni prodhuar ju; nëse është baltë, kjo është balta që keni hedhur ju mbi Shqipërinë, të cilën po e përdorni thjesht dhe vetëm për hir dhe për të kënaqur interesat tuaja.

Kolegë deputetë,

Unë nuk i trembem asnjë dite të jetës sime, dhe e kam për nder, që bashkë me Kryetarin e Kuvendit, zotin Ruçi, jemi të vetmit socialistë në këtë sallë, që jemi që nga kongresi i themelimit të Partisë Socialiste. Kam qenë socialist, jam socialist dhe do të jem socialist, sepse të qënurit socialist nuk e përçakton se çfarë humori ke kur të sheh Kryeministri apo se në cilën pjesë të sqetullës së Kryeministrit e ke vënë kokën.

Unë asnjëherë nuk kam hedhur baltë mbi vendin tim, asnjëherë nuk kam hedhur baltë as mbi Partinë Socialiste, por ndër ju dhe ndër këta këtu, ka nga ata që kur unë dhe zoti Ruçi themeluan Partinë Socialiste, kanë hedhur baltë, kanë hedhur thika, kanë hedhur helm, thika dhe plumba kundër PS-së dhe sot bëjnë moral nën petkun e pseudosocialistit. Por morali i të pamoralshmit është treguesi më i qartë i asaj që ka thënë Ajnshtajni: “Dobësia e sjelljes bëhet dobësi e karakterit”.

Kolegë deputetë, zoti Kryetar i Kuvendit, më lejoni t’ju drejtohem me këtë cilësi në respekt të etikës parlamentare, por edhe në respekt të të gjithë vlerësimit tim për ju, si referencë e vlerave socialiste! Kërkojini menjëherë Kryeministrit të sjellë në Kuvend raportin e Komitetit të

Koordinimit të Luftës kundër Drogës! Kërkojini menjëherë Kryeministrit të zbatojë ligjin dhe të krijojë menjëherë Komitetin e Koordinimit të Luftës kundër Drogës, me qëllim që, në vigjilje të vlerësimit që do të bëjë Komisioni Europian për procesin e çeljes së negociatave, ta kemi plotësuar këtë detyrim, sepse është detyrim ligjor dhe qasja ndaj zbatimit të ligjit, kultivimi i edukatës së ndëshkueshmërisë kur nuk zbatohet ligji, është pa dyshim një kriter domethënës në vlerësimin që do t'i bëhet Shqipërisë në këtë proces. Pandëshkueshmëria duhet të fillojë, së pari, nga ai që nuk e zbaton ligjin. Zbatimi i ligjit nuk është retorikë, nuk është fjalim në Kuvend, por është veprim konkret, vullnet konkret dhe institucion konkret që, në zbatim të ligjit, përmbush detyrimet që ka.

Çelja e negociatave është pa dyshim jo vetëm interesi ynë, pasi integrimi europian i Shqipërisë është një aspiratë kombëtare dhe një prioritet kombëtar. Në emër të LSI-së ne e kemi shprehur dhe unë them se jemi të gatshëm të votojmë dhe të mbështesim, të kontribuojmë, për çdo akt që ndihmon procesin, me qëllim që më 28 qershor të shkojmë me tregues të përmirësuar, por raportet e DASH-it, të Byrosë së Sigurisë Diplomatike, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të Monitorimit Ndërkombëtar të Luftës kundër Drogës dhe raportet e një morie mekanizmash, që aksesojnë gjithë veprimtarinë e qeverisë shqiptare në luftën ndaj krimit dhe, në mënyrë të veçantë, në luftën ndaj trafikut të drogës, nuk japin premisa dhe nuk na bëjnë optimistë.

Nëse ne thjesht rekomandimin e bëmë dhe qeveria e shiti si festë, unë ju ftoj t'i kthehemi punës, ta lëmë festën dhe të punojmë bashkë për të përmbushur detyrimet në kuadër të procesit të integritetit europian, sepse kemi punuar bashkë. Mos u bëni kaq të ligj sa të thoni sot të kundërtën e asaj që keni thënë kur ishim bashkë në qeveri! Mos u bëni kaq cinikë, të paktën me veten tuaj, sepse angazhimet, kontributet dhe produkti ynë i përbashkët bënë të mundur që sot rekomandimi të jepet pa kushte. Por kushtet i vendosni ju vetë dhe kriteri i parë është pa dyshim dialogu politik. Ky kriter duhet të institucionalizohet në këtë sallë, në Kuvendin e Shqipërisë...

*(Drejtimin e seancës e merr zoti Ruçi.)*

**Gramoz Ruçi** – Mbylleti fjalimin, zoti Rama, se ju ka kaluar koha!

**Luan Rama** - Për kriterin e dialogut politik do të duhej të ishte i interesuar Kryeministri i vendit. Për këtë dialog, si bazamenti i të gjithë procesit të çeljes së negociatave, do të duhej të ishte e interesuar fillimisht maxhoranca juaj. Prandaj, t'i lëmë fjalët, ironitë dhe le ta vëmë njëri-tjetrin përballë sprovës së përmbushjes së detyrimeve dhe, pasi t'i kemi përmbushur, të takohemi më 28 qershor e t'i kujtojmë njëri-tjetrit kush është martuar dy herë e kush tri herë!

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Bushati.

**Ditmir Bushati** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Doja vetëm të sqaroja disa të pavërteta që u thanë këtu, për fat të keq, nga parafolësit. Ka disa fakte që janë të vërteta absolute dhe që mund të verifikohen lehtësisht.

Fakt: Komisioni Europian ka rekomanduar nisjen e bisedimeve për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Fakt: nga e gjithë analiza që ka bërë Komisioni Europian për të gjitha fushat, përfshirë luftën kundër korrupsionit, luftën kundër krimit të organizuar, luftën kundër trafikëve të ndryshme të lëndëve narkotike e deri te çështjet e bujqësisë, peshkimit, mjedisit, lëvizjes së lirë të mallrave, të kapitaleve, të shërbimeve e kështu me radhë, nuk ka asnjë fushë ku, sipas Komisionit Europian, Shqipëria të mos ketë bërë progres. Kjo do të thotë se ky rekomandim i Komisionit Europian i pakushtëzuar, i qartë, drejtuar vendeve anëtare për vendimmarrje finale (të cilat bëjnë edhe një gjykim politik jo thjesht vlerësimin teknik, që bën KE-ja), është tregues i reformave që ka ndërmarrë Shqipëria, sidomos gjatë dy viteve të fundit.

Nëse ka një fushë ku Shqipëria bën qartësisht diferencë me vendet e tjera, është a) procesi i vetingut dhe gjithë reforma që është kryer në sistemin e drejtësisë, b) bashkëpunimi shembullor që Shqipëria ka ndërmarrë që në gjenezë me vendet partnere dhe me institucionet e BE-së, qoftë në procesin e vetingut ku bashkëpronësinë në këtë reformë e ka BE-ja, e kanë vendet anëtare, e kanë SHBA-të, si dhe në operacione të ndryshme në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikëve ndërkombëtare, ku qartësisht Shqipëria bën diferencën jo vetëm më



vendet e tjera të rajonit, por edhe me disa vende anëtare të BE-së.

Këto janë fakte. A kemi bërë mjaftueshëm për të thënë që i kemi larë hesapet me krimin e organizuar, me korrupsionin dhe me transformimin e pamatë, që duhet të vazhdojnë shoqëria shqiptare dhe institucionet tona? Natyrisht që jo. U tha këtu se do të na vijë një grup ekspertësh dhe do të bëhet një verifikim tjetër për këto procese. Kjo është totalisht e pavërtetë, pasi Shqipëria është vendi i parë në rajon që e ka hapur derën për ekspertizë jo vetëm për Komisionin Europian, por edhe për misionet monitoruese, që vende të ndryshme, anëtare të BE-së, dëshirojnë të bëjnë në vendet, të cilat synojnë anëtarësimin në BE.

Reformat dhe cilësia e tyre maten me vullnetin që dëshmojnë shtetet në këtë proces. E tha Kryeministri këtu shumë qartë.

Le të flasim për vullnetin politik! Të krahasojmë raportin e DASH-it kur Lulzim Basha i bënte bisht drejtësisë. Çfarë konstatonte raporti? Të krahasojmë raportin e DASH-it në momentin kur ish-ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu, u bishtnonte proceseve të ngritura nga drejtësia. Marrim raportin e DASH-it të vitit 2011, kur 4 qytetarë të pafajshëm u vranë në bulevard nga Garda e Republikës dhe të shohim se çfarë thoshte. Le të marrim raportin e DASH-it, të Komisionit Europian dhe të gjitha llojet e raporteve dhe të lexojmë se çfarë thoshin për kulturën e pandëshkueshmërisë dhe qasjen e ndryshme që ekziston sot, kur për një zyrtar të lartë të shtetit shqiptar ka akoma një akuzë të ngritur nga organet e prokurorisë. Këto janë dallime shumë të qarta jo thjesht etike e politike, por besoj se janë dallime shumë më të rëndësishme sesa historitë e lavdishme për ndërtimin e partive politike në Shqipëri. Është për të ardhur keq që sot këtu asnjë nga dy partitë opozitare nuk u angazhua për të mos bllokuar disa procese jetësore jo vetëm për Brukselin, Parisin e Berlinin, por për qytetarët e zakonshëm të këtij vendi.

A doni më për raportin? Ju jap unë. Lexoni raportin e Komisionit Europian këtë vit, i cili thotë se procesi i vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve u vonua për shkak të bllokimit të opozitës! Prosesi i zbatimit të reformës në drejtësi që ishte kushti që shoqëronte rekomandimin e vitit 2016 për hapjen e

negociatave për Shqipërinë, u bllokua nga bojkoti parlamentar i PD-së. Këto janë të shkruara shumë qartë. Është nga ato rastet e rralla që kemi thënë, që meriton të studiohet jo vetëm nga politologë, por edhe sociologë se si opozita bllokoi zbatimin e një reforme shumë të rëndësishme, e cila do të duhej të ishte e para që ta mbështeste këtë proces.

Prandaj është shumë e rëndësishme që nga ky moment deri në qershor apo kurdo që të jetë vendimmarrja për negociatat për Shqipërinë, dialogun politik, të cilin e kërkoni këtu në parlament, ta ktheni në një dialog të vërtetë, substancial për të mos minuar procesin e reformave shtetkonsoliduese, një proces tashmë i pakthyeshëm.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit, zoti Bushati!

Fjalën e ka zonja Gjebrea.

**Elona Gjebrea** – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Së pari, shpreh keqardhjen që PD-ja nuk është sot për të votuar këtë projektligj kaq të rëndësishëm për grupet në nevojë, sepse herë pas herë del në mbrojtje, por kur vjen puna e fakteve, e tregon me mungesën e saj, ashtu sikurse edhe përfaqësuesit e LSI-së, që kërkojnë ta kalojnë këtë në kalendat greke.

Projektligji që do të miratojmë sot është ndër më të rëndësishmit që ky parlament do të miratojë gjatë këtij mandati. Vlen për t'u përmendur, dhe unë do të përipiqem të flas shkurt, meqenëse edhe Elisa i përmendi, por edhe ministri Ahmetaj, fakti që këtu parashikohen qartë parimet themelore mbi të cilat mbështeten politikat dhe programet e banesave sociale. Po ashtu, përmendet parimi i respektimit të kulturës dhe traditave të komuniteteve ku, pa dyshim, strukturat vendore kanë detyrimin dhe përgjegjësinë për të ndihmuar grupet në nevojë përmes programeve të strehimit social.

Ky projektligj është një risi edhe për mënyrën si ndërthuren programet e strehimit me shërbimet sociale, si punësimi, shëndetësia etj. Vlen të përmendet parashikimi i fondit publik të banesave sociale dhe mënyra e krijimit të fondeve të këtyre banesave. Në këtë projektligj parashikohen tri programe të suksesshme të reja të strehimit social, si: programi i zhvillimit të

zonës, me qëllim strehimin, programi i strehëve të përkohshme, si dhe programi i banesave të specializuara.

Ky projektligj është krijimi i mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet në nevojë, duke shtuar masa konkrete, me qëllim promovimin, mbrojtjen dhe sigurimin e plotë dhe progresiv të kësaj të drejte.

Po ashtu, risi në këtë projektligj është kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik, duke përcaktuar qartë statusin e pronarit social.

Në këtë projektligj përcaktohet qartë subvencionimi i qirasë, programi i banesave me kosto të ulët dhe programi i zhvillimit të zonës me qëllim strehimi. Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha kostot shtesë financiare janë pjesë e buxhetit të shtetit. Një pjesë e tyre do të përballohet nga buxheti qendror dhe nga buxheti i njësisve të qeverisjes vendore. Po ashtu, nuk ka asnjë strukturë të posaçme në nivel qendror që të ketë kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

Ky projektligj ka një rëndësi të madhe, sepse për herë të parë mbështeten grupet në nevojë. Vlen për t'u theksuar se janë grupe vulnerabël, që në shumë raste mbivendosen me njëri-tjetrin, kështu që qasja ndaj tyre nuk mund të jetë e njëjtë. Vlen të theksohen individët me statusin e jetimit, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit, invalidët e punës, familjet e policëve të rënë në krye të detyrës, emigrantët e kthyer, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, viktimat e tjera të mundshme.

Një element i rëndësishëm është sistemi i pikëzimit, i hartuar nga INSTAT-i, që vendos këtë nivel rehabilitimi për ata që janë potenciale për të përfituar nga strehimi social dhe për çdo njësi të qeverisjes vendore.

Po ashtu, vlen të theksohet kombinimi i ligjit kundër diskriminimit, duke ofruar mbrojtje nga diskriminimi në ndarjen e banesave dhe përmirësimin e strehimit për minoritetin rom dhe egjiptian.

Për herë të parë ky projektligj ka pasur një konsultim kaq të gjerë. Vlen të theksohet konsultimi me të gjitha nivelet qendrore, me bashkitë, me të gjithë personat e interesuar dhe me organizata të ndryshme.

Nga ana tjetër, duke marrë parasysh të gjitha rekomandimet ndërkombëtare, për herë të

parë ka edhe një ndërthurje kaq të mirë të të gjitha rekomandimeve dhe konventave: rekomandimi GREVIO, Amnesty International, Komisioni European Kundër Racizmit dhe Tolerancës, parimi i konventave ndërkombëtare europiane e të tjera.

Do të doja të theksoja punën e madhe që është bërë gjatë mandatit 4-vjeçar të zonjës Gjermani në Ministrinë e Zhvillimit Urban për të arritur në këtë projektligj.

Gjithashtu, do të doja të falënderoja të gjitha komisionet dhe kolegët, të cilët kanë punuar dhe kanë dhënë vlerë të vyer gjatë shqyrtimit të projektligjit për të arritur në pikën që jemi.

Do të doja të theksoja diçka për sa i përket pjesës së trafikimit, meqenëse e kam mbuluar si sektor. Dua të sjell edhe një herë në vëmendjen tuaj se në ç'gjendje e gjetëm në trafikimin në vitin 2013. E gjetëm në një pikë të zezë, ku vendi rrezikonte mungesën e financimeve edhe në fusha të tjera dhe ne arritëm që brenda një viti të ngrihem në një kategori më lart, kategoria 2, por sërish ka shumë punë për të bërë.

Fakti që sot kemi një projektligj që u vjen në ndihmë jo vetëm viktimave të trafikimit, por edhe viktimave të mundshme të trafikimit, tregon pikërisht atë që bën kjo maxhorancë për grupet në nevojë, që e ka shprehur qartë edhe në programin e saj, qoftë në mandatin e parë të qeverisë "Rama", qoftë gjatë këtij mandati.

Ky projektligj tregon edhe një herë vizionin që ka kjo maxhorancë për këto grupe vulnerabël dhe nuk e ekzagjeroj nëse them se është një projektligj historik, ku për herë të parë ka një përkujdesje për kaq shumë grupe në nevojë, që është tashmë prioritet dhe do të jetë prioritet i qeverisë dhe i kësaj maxhorance.

Për të gjitha këto, të nderuar deputetë, ju ftoj ta votojmë këtë projektligj!

Ndërkohë, dua të them disa gjëra për vizitën timen në Angli. Sapo jam kthyer nga një takim me disa parlamentarë nga Londra, të cilët kanë krijuar një "all fact group" kundër trafikimit të personave dhe shpreh mbështetje për të gjithë punën që ne si qeveri kemi bërë në luftën kundër trafikimit dhe dëshirën për të krijuar një grup më të gjerë.

Në korrik do të kemi një konferencë të madhe me pjesëmarrjen e shumë parlamentarëve

nga vendet e Ballkanit dhe të Europës pikërisht për të adresuar këtë problem.

Po ashtu, kam pasur vizitë edhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme, e cila tregon edhe një herë vendosmërinë që ka qeveria në luftën kundër trafikimit të personave dhe krimit të organizuar.

Është abuzuar shumë me raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit apo me raportet e progresraportit europian, që të cilën e përmendi edhe ministri Bushati. Unë i kam parë me vëmendje këto raporte që nga viti 2009 deri më sot. Patjetër që theksohet fenomeni, por në mënyrë të dukshme tregohen arritjet dhe progresi që ka bërë Shqipëria ndër vite dhe nuk ka nevojë për komente. Mjafton që ata, të cilët flasin për raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit apo për progresraportin, të tregohen të kujdesshëm dhe të lexojnë raportin e detajuar, pasi jam shumë e bindur që nuk e lexojnë fare dhe thjesht luajnë rolin e tellallit nga një televizion në një tjetër, aq më keq kur përdorin këtë foltore dhe këtë vend serioz, ku duhet të flitet vetëm seriozisht dhe jo thjesht për t'u tallur.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Fjala është për zotin Balla.

**Taulant Balla** – Faleminderit, zoti Kryetar!

Së pari, kam një përgënjeshtim për kolegun Luan Rama, që ka të bëjë me Komitetin Kombëtar të Luftës Kundër Substancave Narkotike. Ky komitet mblidhet në mënyrë periodike nga viti 2013 dhe miraton strategjitë e qeverisë sonë në luftën pa kompromis kundër çdolloj forme trafikimi, në rastin në fjalë, të substancave narkotike.

Së dyti, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste sot mbështet fuqimisht një projektligj, i cili në historinë e këtij Kuvendi, por edhe në historinë e qeverisjes së majtë të këtij vendi është një prej faqeve tona më sociale.

Unë jam shumë krenar që do t'u them sot të gjitha familjeve, të cilat prej vitesh kanë një hall të pazgjidhur për një nga çështjet më të rëndësishme, atë të strehimit, të gjitha komuniteteve të varfra e të pafavorizuara të shoqërisë, që me këtë projektligj hapim një fazë të re të trajtimit social të të gjitha familjeve të pastreha.

Fakti që projektligjin e prezantoi edhe ministri i Financave dhe Ekonomisë është një garanci shtesë për mbështetjen financiare të programeve sociale të strehimit, si dhe dëshmon rëndësinë që qeveria i ka kushtuar këtij sektori, i cili nuk ka vetëm impakt social, por, duhet ta themi, ka edhe impakt ekonomik.

Pas këtij projektligji, në emër të grupi parlamentar, unë do ta nxisja qeverinë të vinim me një paketë tjetër mbështetëse për strehimin, që ka të bëjë me të gjitha familjet e reja. Të gjitha çiftet e reja, që sapo martohen, sikurse edhe në vende të tjera të ngjashme me Shqipërinë, qeveria duhet t'i mbështesë me një paketë subvencioni për apartamente, për të ndërtuar edhe ata familjen e tyre në një strehë, në një banesë, sepse ky është një model social në disa vende.

Gjatë viteve 2014-2017 ndryshoi tërësisht qasja jonë, qasja e qeverive përkundrejt familjeve të pastreha. Janë 35 miliardë lekë të dhëna nga qeveria jonë për trajtimin e familjeve të pastreha, por kemi edhe 550 milionë lekë të dhëna për investime për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet rome dhe egjiptiane. Asnjëherë më parë, deri në vitin 2014, nuk ishin dhënë kaq shumë fonde dhe, sigurisht, këtu gjej rastin të falënderoj Eglantina Gjermanin për punën e shkëlqyer në sektorin e Entit Kombëtar të Banesave, drejtuesit të Entit Kombëtar të Banesave, që më në fund e vunë në punë këtë institucion.

Dua të them se grupi ynë parlamentar bashkë me qeverinë, edhe në kuadër të llogaridhënies publike, do të organizojnë në çdo cep të territorit dëgjesa me banorët. Do t'i ftoj banorët, të cilët kanë problematika të strehimit, të bëhen pjesë e dëgjesave publike të llogaridhënies publike të qeverisë për të sqaruar të gjitha çështjet dhe risitë që sjell projektligji "Për strehimin social".

Duke e falënderuar qeverinë, tashmë si kryetar i grupit, jo si një nga deputetët folës në foltore, do të doja t'i kërkoja Kryetarit të Kuvendit të kalonim në diskutime në emër të grupeve!

I falënderoj, pse jo, edhe kolegët e LSI-së, që qëndrojnë në sallë për ta mbështetur projektligjin, sepse, në fund të fundit, është një projektligj tipik i majtë, ku, më në fund marrim një masë: ata që fitojnë më shumë, do të

paguajnë më shumë, sikurse kemi bërë edhe me taksën progresive. Ata që fitojnë më shumë, paguajnë më shumë, ata që fitojnë më pak, paguajnë më pak.

Gjëja më e rëndësishme është se në çdo ndërtim mbi 2000 m<sup>2</sup> për qëllim banimi, 3% e tij i kalon fondit për banesat sociale. Sigurisht, jo vetëm në Tiranë, por edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë, ne do kemi mundësi ta bëjmë efektiv këtë hap të rëndësishëm që ka ndërmarrë qeveria.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Atëherë, meqenëse tërhiqen diskutantët e tjerë, kalojmë në diskutimet në emër të grupeve.

Fjala për zonjën Almira Xhembulla.

**Almira Xhembulla** – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Në qytetin tim, në qytetin e çdonjërit prej jush, në lagjen time, në lagjen tuaj, në familjen time, në familjen e gjithsecilit prej jush është gjithmonë dikush apo janë gjithmonë disa që kanë nevojë për strehim, që kanë nevojë të mbështeten, është një grua e dhunuar, është një fëmijë i braktisur, është një person me aftësi ndryshe, është një person që rrezikon jetën çdo ditë për ne dhe shumë e shumë raste të tjera, që kanë nevojë të kenë një shtëpi, që janë kategori prioritet e që duhet të mbështeten, sigurisht, akoma më shumë.

Strehimi social ka qenë dhe mbetet një ndër prioritetet e qeverisë. Gjatë periudhës 2014-2017 janë akorduar 35 miliardë lekë nga buxheti i shtetit, nga të cilat rreth 550 milionë lekë për investime në përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve rome e egjiptiane dhe diferenca është dhënë për subvencione. Këto fonde kanë lehtësuar kostot e strehimit për rreth 6 mijë e 500 familje në të gjithë vendin. Janë hartuar një sërë strategjish dhe dokumentesh, si: Strategjia 10-vjeçare për Strehimin Social; aplikimi i instrumentit të bonusit të strehimit, nëpërmjet të cilit, nga buxheti i shtetit, paguhet qiraja për shtresat vulnerabël; studimi i vlerësuar për situatën e vendbanimeve rome dhe egjiptiane, si dhe hartëzimi i këtyre vendbanimeve në të gjithë Shqipërinë; studimi për identifikimin e trojeve të lira në disa qytete të vendit për ndërtimin e objekteve sociale; programe për përmirësimin e kushteve të komuniteteve rome dhe egjiptiane, të mbështetura nga buxheti i shtetit dhe të

investuara për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese.

Por, pavarësisht mbështetjes së madhe që kanë marrë grupet më të pafavorizuara, është konsideruar se instrumentet financiare të deritanishme dhe programet që parashikonte ligji ekzistues kanë qenë të pamjaftueshme për mbështetjen masive të grupeve specifike, veçanërisht ato me të ardhura të ulëta, pa të ardhura, të moshuar që kanë nevojë për përkujdesje, gra të dhunuara e të trafikuar, që kanë nevojë për mbrojtje të veçantë, fëmijë të mitur e të trafikuar dhe grupe të tjera specifike, për të cilat parashikohen programe të specializuara strehimi.

Sot ne ndihemi jashtëzakonisht mirë, besoj edhe kolegët që nuk janë në sallë, dhe këtë nuk e vë në dyshim, sepse kemi mundësi të kemi para nesh për të votuar një nga projektligjet më esenciale për sa i përket mbështetjes së grupeve në nevojë, që, përpos diskutimeve, u mirëprit dhe u votua pro edhe në parim gjatë diskutimeve në komisione, një nga politikat më tipike të majta, me një impakt real social për grupet në nevojë.

Si anëtare e komisionit përgjegjës, si raportore e këtij projektligji dhe anëtare e maxhorancës, i falënderoj pafund kolegët, ekspertët dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, të cilët punuan intensivisht për ta sjellë projektligjin në formën që ka sot, relevant, i zbatueshëm dhe sipas standardeve dhe normave europiane!

Ky projektligj rregullon mundësinë për akses në strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm për familjet në nevojë, duke u kushtuar vëmendje masave konkrete, me qëllim promovimin, mbrojtjen dhe sigurimin e plotë e progresiv të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Objektivi i projektligjit është vendosja e rregullave, procedurave dhe modaliteteve administrative për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim.

Ligji sjell për herë të parë disa parime thelbësore, të cilat derivojnë nga konventa ndërkombëtare e europiane dhe mbështetjet në disa parime thelbësore. Disa nga parimet kyçe janë: siguria e qëndrimit, strehim i përbalueshëm dhe strehim i përshtatshëm, i cili u referohet disa standardeve, si hapësirave të

mjaftueshme, mbrojtjes nga moti, eficiencës së energjisë dhe shërbimet brenda banesës.

Janë tri programe të reja që adresojnë shtresat më në nevojë:

1. Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese.

2. Programi për krijimin e banesave të përkohshme, të cilat janë të domosdoshme në kushtet e adresimit të nevojave emergjente, siç janë rastet e fatkeqësive natyrore

3. Programi i banesave të specializuara, të cilat adresojnë problemet sociale të grupeve të veçanta,

Disa nga instrumentet e reja që parashikon ky projektligj janë:

Kontributi i sektorit të ndërtimit për sigurimin e banesave sociale.

Me miratimin e ligjit, çdo subjekt privat, që ndërton mbi 2000 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi, kalon në pronësi të bashkisë 3% të sipërfaqes për t'u përfshirë në fondin publik të banesave sociale.

Kontributi i sektorit të ndërtimit për krijimin e fondit publik të banesave sociale, rrjedh nga e drejta e publikut për të përfitur nga zhvillimet që ndodhin në territorin e qytetit të tij.

Kontributi i sektorit privat mbështetet në nenin 59 të Kushtetutës së RSH-së, i cili thotë: "Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim".

Sipas Kushtetutës, shteti bashkëpunon me sektorin privat duke e konsideruar strehimin edhe si përgjegjësi sociale të nismës private.

Bashkëpunimi në tërësi me sektorin privat, në rastet e zhvillimit të një zone me qëllim rezidencial, është si bashkëpunimi i pronarit privat të truallit me sipërmarrës privatë për zhvillimin e pronës së tij. Me të njëjtën formë do të bashkëpunojë edhe shteti (njësitë e vetëqeverisjes vendore ose ato të qeverisjes qendrore). Sipërfaqet e përfutuara do të kalojnë në pronësi të bashkisë, e cila do t'i përdorë si banesa sociale me qira

Edhe një here, dua të theksoj që për herë të parë me ligj adresohet ndërlidhja midis politikave të strehimit dhe atyre të punësimit. Dihet që pengesa kryesore për të siguruar një strehim të përshtatshëm janë të ardhurat që siguron familja. Për të adresuar këtë problem, politikat e strehimit, veçanërisht për të rinjtë, do

të mbështeten nga politikat e punësimit dhe të trajnimit profesional.

Ligji i ri krijon më shumë hapësira për adresimin e grupeve të ndryshme sociale nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucioni publik që do të ngrihet, do të organizohet dhe do të funksionojë sipas përcaktimeve që do të bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ndërkohë, ne, sigurisht, që jemi të ndërgjegjshëm për sfidat dhe problematikat e këtij sektori dhe të kësaj çështjeje shumë delikate, por ky ligj do të na japë mundësinë të bëjmë akoma më shumë në këtë drejtim.

Ne do të angazhohemi të arrijmë një marrëveshje bashkëpunimi edhe me bankat, sepse ndodh që procesi ngec në dyert e tyre dhe njerëzit enden të zhgënjyer e të lodhur nga burokracitë.

Ne nuk do të bëjmë më lista që të strehohen persona politikë që vijnë nga partia dhe kanë 3-4 shtëpi, nuk do të përsërisim kurrsesi gabimet e së shkuarës.

Ne, socialistët, do t'u japim mundësi të gjithë atyre që, realisht, kanë nevojë të përfitojnë nga ky ligj, të përfitojnë nga mundësia që do u japim ne sot me votën tonë.

Ashtu siç e theksoi kryetari i grupit, do të doja që gjithsecili nga ne të angazhohet për ta çuar informacionin te grupet në nevojë dhe strukturat përgjegjëse, në momentin që ky ligj të hyjë në fuqi dhe të vazhdojnë implementimin e tij.

Ndiej keqardhje që kolegët e opozitës nuk ndodhen në sallë, por ne do të vazhdojmë punën sipas programit dhe prioritetëve tona, do të bëjmë akoma më shumë për shtresat në nevojë, do të bëjmë atë për të cilën na kanë votuar qytetarët.

Ju ftoj ta votojmë këtë projektligj dhe u uroj suksese Ministrisë së Financave dhe të gjitha strukturave përgjegjëse gjatë zbatimit në vijimësi të ligjit!

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – Ju lutem, bëhemi gati për votim!

Të hiqen kartat e deputetëve që s'janë të pranishëm në sallë!

Fillojmë me votimin për prezencën.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Zoti Majko nuk është. T'i hiqet karta!

Zotit Rama t'i hiqet karta!

75 deputetë janë prezentë.

Fillojmë me votimin e raportit të veprimtarisë vjetore të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017.

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores, votojmë projektrezolutën, e cila kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

Një votim me elektronikë, votim i hapur.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

73 deputetë pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektrezoluta.

Fillojmë me projektligjin “Për strehimin social”.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen me kartonë, me vërejtjet e bëra nga komisioni përgjegjës, reflektuar në variantin integral që keni përpara. Do të ndalemi vetëm te një amendim që ka bërë zonja Gjebrea.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Para se të kalojmë te neni 2, është depozituar një amendim nga deputetja Elona Gjebrea 24 orë përpara fillimit të seancës.

Zonja Gjebrea, keni fjalën, në qoftë se dëshironi.

Urdhëroni!

**Elona Gjebrea** – I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 75, pikat 3 dhe 4, të Rregullores së Kuvendit, kërkoj që, për sa i përket projektligjit “Për strehimin social”, neni 1/51, pas fjalisë “viktimë e mundshme e trafikimit”, personi, për të cilin agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar gjykojnë se mund të jetë trafikuar të shtohet edhe fjalia që e përcakton se ku bazohet kjo gjë. “Viktimë e mundshme e trafikimit” ka të njëjtin kuptim, sipas procedurës standarde dhe veprimit, me VKM-në nr. 582, datë 27.07.2011, “Për miratimin e procedurës standarde të veprimit për identifikimin dhe

referimin e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit”.

Ky amendament kërkohet për të ruajtur të njëjtin standard edhe me përkufizimin e grupeve të tjera vulnerabël, të cilat janë të parashtruara në këtë projektligj, si dhe për të shpjeguar se ku bazohet ky përkufizim.

Faleminderit!

**Gramoz Ruçi** – A ka kundërshtime apo mbështetje për amendimin e

bërë nga zonja Gjebrea?

Zonja zëvendëskryetare e Komisionit të Çështjeve Sociale, zoti Ministër?

Atëherë, e hedhim në votë.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet amendimi i bërë nga zonja Gjebrea.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

*(Nga neni 6 deri te neni 18 ndiqet e njëjta procedurë votimi.)*

Urdhëroni, te neni 19!

**Ervin Bushati** – I nderuar Kryetar,

Te neni 19 kemi një saktësim: “Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000m<sup>2</sup>, siguron kalimin pa shpërbllim të të paktën 3% të sipërfaqes funksionale me kushtet e një strehimi të përshtatshëm në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në raste pamundësie për t’u dhënë si sipërfaqe ndërtimore banimit, mund të zëvendësohet me një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi dhe shtohet për plotësim kontrata, që nënshkruhet mes palëve, për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, që regjistrohet në zyrën e përmbarimit të pasurive të paluajtshme”.

Ky është plotësimi.

**Gramoz Ruçi** - Pra, me pak fjalë shtohet fjalia “Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore, në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në zyrën e përmbarimit të pasurive të paluajtshme”.

**Ervin Bushati** – Po, neni 19, pika 1. Në krye kemi një saktësim: “Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi”.

**Gramoz Ruçi** – Po, pas hyrjes në fuqi të ligjit, se, në qoftë se nuk hyn ligji në fuqi...

*(Ndërhyrje të ministrit Ahmetaj pa mikrofon)*

Zoti Ministër, a keni ndonjë kundërshtim, thotë zoti Braçe?

*(Ndërhyrje e deputetit Braçe pa mikrofon)*

Kush është dakord me propozimi e zotit Bushati?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 22.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 23.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 24.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 25.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

*(Nga neni 26 deri te neni 79 ndiqet e njëjta procedurë votimi.)*

Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

73 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Këtu mbyllet seanca.

Seancën tjetër do ta njoftojmë në faqen e Kuvendit ose në media. Faleminderit!

*(Seanca u mbyll në orën 13:15.)*

**Kryetari i Kuvendit**

**Gramoz Ruçi**

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve  
Parlamentare  
Krenar Hajdëri**